Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

ZGJEDHJE LOKALE
24 mars dhe 7 prill 2013

OSBE/ODIHR Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
Raporti Përfundimtar

Varshavë
9 korrik 2013

TABELA E PËRMBAJTJEVE

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR 1

II. HYRJE DHE MIRËNJOHJE 3

III. KONTEKSTI POLITIK 3

IV. KORNIZA LIGJORE 4

V. SISTEMI ZGJEDHOR 5

VI. ADMINISTRATA ZGJEDHORE 6

VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE 8

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE 9

IX. FUSHATA ZGJEDHORE 11

X. FINANCIMI I FUSHATËS 13

XI. MEDIAT 15

- **A. KLIMA MEDIATIKE 15**
- **B. KORNIZA LIGJORE 15**
- **C. VËZHGIMI I MEDIAVE NGA MVZ-JA E OSBE/ODIHR-SË 17**

XII. VËZHGUESIT NDËRKOMBËTARË DHE TË QYTETARËVE 18

XIII. ANKESAT DHE PARASHTESAT PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE 18

XIV. DITËT ZGJEDHORE 20

- A. VOTIMI NË RRETHIN E PARË 20
- B. VOTIMI NË RRETHIN E DYTË 21
- C. NUMËRIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE 21

XV. ANKESAT DHE PARASHTESAT PASZGJEDHORE 22

- A. ANKESAT DHE PARASHTESAT PËR DITËN E ZGJEDHJEVE NË RRETHIN E PARË 22
- B. ANKESAT DHE PARASHTESAT NË RRETHIN E DYTË 23

XVI. REKOMANDIME 24

- **A. REKOMANDIME PRIORITARE 24**
- **B. REKOMANDIME TË TJERA 25**

XVII. REZULTATET PËRFUNDIMTARE 28

RRETH OSBE/ODIHR-IT 30

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË
ZGJEDHJE LOKALE
24 mars dhe 7 prill 2013

Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve[1]

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Pas ftesës së marrë nga Ministria për Punë të Jashtme, OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) themeloi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të vitit 2013. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe legjislacionin kombëtar. Për vëzhgimin e zgjedhjeve më 24 mars, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së i bashkoi përpjekjet me një delegacion vëzhgues nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së qëndroi në vend për ta vëzhguar edhe rrethin e dytë më 7 prill.

Zgjedhjet lokale të 2013 u administruan në mënyrë efikase dhe ishën me konkurrencë të lartë. Megjithatë, mbulimi partiak mediatik dhe mosndarja e qartë e aktiviteteve shtetërore dhe atyre partiake, nuk ofruan mundësi të barabarta për garimin e kandidatëve në zgjedhje. Janë të nevojshme përpjekje të mëtutjeshme për t'i trajtuar mangësitë dhe dykuptimësitë në Kodin Zgjedhor, dhe për përmirësimin e besimit në listën e votuesve. Në përgjithësi të dy ditët zgjedhore ishën të qeta dhe të organizuara, edhe pse u vërejtën disa parregullësi procedurale.

Zgjedhjet u mbajtën gjatë bojkotimit të Kuvendit dhe shpalljes për bojkotimin e zgjedhjeve nga ana e Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM), që përfundoi më 1 mars, në bazë të marrëveshjes së ndërmjetësuar nga Bashkimi Europian, ndërmjet udhëheqësve të LSDM-së dhe të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE).

Korniza ligjore zgjedhore është gjithpërfshirëse. Përveç amandamenteve në nëntor të vitit 2012, Kodi Zgjedhor gjithashtu u ndryshua disa javë para zgjedhjeve, edhe atë për ta vazhduar afatin për paraqitjen e kandidatëve. Ndonëse nuk është praktikë e mirë që korniza ligjore të ndryshohet më pak se një vit para zgjedhjeve, ndryshimi i fundit u bë me konsensus gjithëpartiak. Kodi Zgjedhor ende ka mungesë të detajeve kyçe lidhur me regjistrimin e votuesve, regjistrimin e kandidatëve, bërjen fushatë, financimin e fushatës, mbulimin mediatik dhe ankesat dhe parashtesat. Këto zbraztira krijuan hapsirë për interpretime konfliktuoze dhe zbatim jokonzistent të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) funksionoi në mënyrë efikase dhe transparente, duke iu përmbajtur shumicës së afateve të caktuara zgjedhore. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të ankesave dhe parashtesave, KSHZ-ja votoi përgjatë vijave etnike, gjë e cila ndikon negativisht në paanshmërinë dhe kolegialietin e saj. Përderisa mbledhjet e KSHZ-së ishin të hapura për publikun, disa komisione zgjedhore komunale (KZK) nuk njoftuan paraprakisht për mbledhjet e tyre dhe morrën vendime në grupe joformale të punës, duke e zvogëluar kështu transparencën e punës së tyre. Shumica e KZK-ve u ballafaquan me problem financiare, për shkak se nuk i morrën në kohë fondet e nevojshme.

[1] Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

Të drejtë vote në këto zgjedhje kishën gjithsej 1,743,403 qytetarë. Sipas Ministrisë për Punë të Brenshme, rreth 119,000 persona janë mënjanuar nga lista zgjedhore e votuesve për shkak se nuk kanë pasur letërnjoftime ose pasaporta biometrike. Pastrimi i listës zgjedhore të votuesve e gëzoi përkrahjen e të gjitha partive kryesore. Përkundër besimit të shtuar në saktësinë e listës zgjedhore të votuesve, disa ankesa vazhduan të parashtrohen, duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve. Siqë është cekur në raportet paraprake të MVZ-së së OSBE/ODIHR-së procedurat për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e listave do të kenë dobi nga përmirësime të mëtutjeshme.

Regjistrimi i kandidatëve ishte përfshirës dhe u ofroi votuesve përzgjedhje të ndryshme. U dorëzuan gjithsej 350 lista për kryetarë komunash dhe 480 lista për këshilla komunalë nga 16 parti politike, 8 koalicione dhe 97 grupe qytetarësh. Mirëpo, vazhdimi i afatit për paraqitjen e kandidatëve në këto zgjedhje nuk vlente në mënyrë të barabartë edhe për kandidatët e pavarur. Kjo është në kundërshtim me parimet që janë paraparë në paragrafet 7.5 dhe 7.6 të OSBE Dokumentit të Kopenhagës të vitit 1990, ku kërkohet nga autorietet që ta respektojnë të drejtën e të gjithë kandidatëve për të garuar për funksione publike, pa kurrfarë diskriminimi.

Në përputhje me kërkesat ligjore, një në çdo tre vende në listat e kandidatëve për këshilltarë, në përgjithësi, ishte i rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar. Edhe pse më parë nuk kishte asnjë kryetare komune, në këto zgjedhje u zgjodhën 4 nga 32 femra kandidate. Kriteri për përfaqësimin gjinor në organet e administratës zgjedhore në përgjithësi u respektua.

Kandidatët kishën mundësi që të bëjnë fushatë të lirë dhe pa pengesa. Edhe pse fushata ishte aktive, në disa raste u njollos me tensione ndëretnike. Akuzat për frikësimin e votuesve ishën të pranishme gjatë të gjithë procesit zgjedhor dhe MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së vërejti disa raste të keqpërdorimit evident të resurseve shtetërore për qëllime të fushatës. Kjo shtoi brengën për mundësinë e votuesve për ta dhënë votën e tyre "lirisht pa patur frikë nga pasojat", siqë edhe kërkohet në paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së. Përzierja e aktivitetve shtetërore dhe partiake gjithashtu nuk është në përputhje me paragrafin 5.4 të OSBE Dokumentit të Kopenhagës.

Amandamentet e fundit në legjislacionin për financimin e fushatës i përmirësuan afatet kohore, transparencën dhe udhëzimet për dorëzimin dhe revizionin e raporteve. Megjithatë, shqetësime ende mbesin sa u takon detajeve të raportimit, dispozitat për zgjedhjet në rrethin e dytë, dhe pragjet e ndryshme për donacione të bëra nga individë dhe persona juridik.

Në vend ka një numër të madh të mediave dhe ato janë të ndara përgjatë vijave etnike dhe politike. Që nga zgjedhjet e fundit, mbyllja e dy mediave elektronike dhe një numër të mediave të shtypit e ka zvogluar dukshëm numrin e mediave të cilat kanë qëndrim kritik ndaj qeverisë. Ndërkohë që mediat e vëzhguara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së siguruan mbulim të gjerë të fushatës zgjedhore në lajmet e tyre, transmetuesi publik dhe shumica e transmetuesve privat shfaqën një favorizim të dukshëm ndaj partive në pushtet. Mediat elektronike rregullisht i përcjellnin aktivitetet qeveritare por dështuan që të bëjnë dallim mes aktiviteteve shtetërore dhe fushatës së partisë. Përderisa transmetuesi publik ndau kohë të lirë për emitim pa pagesë për kandidatët dhe krijoi një program special për t'i prezantuar aktivitetet e fushatës, këto u emituan jashtë periudhës me shikueshmëri më të madhe, duke e kufizuar numrin e shikuesve potencial.

Të dy ditët zgjedhore ishën të qeta dhe të organizuara, edhe pse u vërejtën disa parregullësi procedurale. Vazhduan rastet e votimit grupor dhe fshehtësia e votës jo gjithmonë u respektua. Disa parti dhe

vëzhgues e shprehën shqetësimin e tyre lidhur me numrin e qytetarëve nga diaspora të cilët ktheheshin në vend për të votuar pa mos pasur vendbanim, siqë edhe kërkohet nga vetë ligji. Vëzhgimi i numërimit të votave në përgjithësi u vlerësua pozitivisht, edhe pse në disa raste u vërejtën lëshime procedural. Gjatë të dy rretheve, procesi i numërimit të votave u zhvilluar në mënyrë profesionale, edhe përpos të disa problemeve teknike të cilat u shfaqën në rrethin e parë. Rezultatet e parakohshme nga të dy rrethet u shpallën në ueb faqen e KSHZ-së, ashtu siqë u pranuan nga KKZ-të, të ndara sipas komunave dhe vendvotimeve.

KSHZ-ja nuk solli vendim për shumicën e ankesave të dorëzuara para dhe pas ditës zgjedhore, dhe në këtë mënyrë u mohoi ankuesve një ilaç efektiv siqë është paraparë në paragrafin 5.10 të OSBE Dokumentit të Kopenhagës. Gjykata Administrative i shqyrtoi ankesat në mënyrë formale dhe vendimet nuk ishën të përmbajtura. Kryetari i Gjykatës Administrative dha dorëheqje pas shpalljes së vendimit të Gjykatës lidhur me sfidat në rrethin e dytë. KSHZ-ja i shpalli rezultatet finale më 23 prill.

II. HYRJE DHE MIRËNJOHJE

Pas ftesës së marrë nga Ministria për Punë të Jashtme për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të 24 marsit, dhe në bazë të rekomandimeve nga Misioni për Vlerësimin e Nevojave të zhvilluar prej më 28 deri më 31 janar, OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) themeloi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 25 shkurt. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së u kryesua nga Ambasadori Geert-Hinrich Ahrens dhe përbëheshte nga 11 ekspertë të bazuar në Shkup dhe vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin.[2]

Për ditën e zgjedhjeve më 24 mars, u shpërndanë 215 vëzhgues afatshkurtër, përfshirë edhe delegacionin 15 anëtarësh nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Nga gjithsej 2,976 vendvotime, votimi u vëzhgua në 831 prej tyre. Numërimi i votave u vëzhgua në 80 vendvotime. Nga gjithsej 81 KZK, procesi i grumbullimit të rezultateve u vëzhgua në 66 nga 81 komisione zgjedhore komunale. MVZ mbeti në vend me kapacitet të zvogluar për ta vëzhguar rrethin e dytë të zgjedhjeve më 7 prill. Gjithsej, kishte vëzhgues nga 30 shtete anëtare të OSBE-së.

Procesi zgjedhor u vlerësua nga aspekti i përputhshmërisë së tij me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin vendor. Ky raport përfundimtar pason pas dy Deklaratave për Konstatimet dhe Përfundimet Preliminare të publikuara më 25 mars dhe 8 prill.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së falenderon Ministrinë për Punë të Jashtme për ftesën për t'i vëzhguar zgjedhjet, Komisionin Shtetëror Zgjedhor për bashkëpunimin dhe për sigurimin e dokumenteve për akreditim, dhe autoritetet e tjera shtetërore dhe lokale për ndihmën dhe bashkëpunimin. OSBE/ODIHR-ja gjithashtu shpreh mirënjohje ndaj OSBE Misionit në Shkup dhe përfaqësive diplomatike të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, dhe organizatave ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre përgjatë tërë misionit.

III. KONTEKSTI POLITIK

[2] Të gjitha raportet paraprake të OSBE/ODIHR-së janë të qasëshme në: http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom.

Pas përjashtimit të dhunshëm të deputetëve opozitarë dhe të mediave nga Kuvendi gjatë votimit për buxhetin vjetor të shtetit më 24 dhjetor 2012, Partia Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM) dhe disa nga partnerët e saj të koalicionit filluan ta bojkotojnë punën e Kuvendit. Më 2 janar 2013, LSDM-ja njoftoi se do t'i bojkotojë edhe zgjedhjet lokale përderisa nuk plotësohen disa kërkesa.[3] Tre partitë më të mëdha etnike shqiptare, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) dhe Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) nuk iu bashkangjitën bojkotit dhe e shpallën qëllimin e tyre për të garuar gjatë zgjedhjeve që nga sjellja e vendimit për organizimin e tyre më 11 janar.

Partia në pushtet, Organizata e Brendshme Revolcionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe LSDM-ja nuk ishin në gjendje të gjejnë kompromis për t'i dhënë fund krizës politike. Bojkotimi i zgjedhjeve lokale nga opozita përfundoi më 1 mars, vetëm pasi që Bashkimi Evropian ndërmjetësoi një marrëveshje ndërmjet udhëheqësve të këtyre dy partive.[4] Në një seancë urgjente e cila u mbajt ditën e ardhshme, Kuvendi e vazhdoi afatin për regjistrimin e kandidatëve deri më 8 mars për tu mundësuar kandidatëve nga opozita që të regjistrohen.

Si rezultat i krizës politike, zgjedhjet fituan një rëndësi edhe më të madhe politike, jashtë suazave lokale. Lideri i koalicionit të VMRO-DPMNE-së këto zgjedhje i përshkroi si referendum për ardhmërinë e vendit, ndërsa kryetari i LSDM-së theksoi që rezulatet e zgjedhjeve do të përcaktojnë nëse duhet të mbahen zgjedhje të parakohshme parlamentare ose jo. Poashtu, këto zgjedhje në masë të gjerë u konsideruan si një test i rëndësishëm në kontekst të ambicies së përbashkët të të gjitha partive kryesore politike për ta avancuar integrimin euroatlantik të vendit.

Zgjedhjet lokale të vitit 2013 ishin të parat pas bashkimit të pesë komunave në komunën e vetme të Kërçovës.[5] Zvoglimi i numrit të komunave dhe ndryshimi i profilit demografik të Kërçovës, krijoi një konkurrencë të shtuar ndëretnike në garën për kryetar të kësaj komune dhe këshillin e komunës.

IV. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore për zgjedhjet lokale kryesisht përcaktohet me Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor.[6] Kodi Zgjedhor u ndryshua në nëntor të vitit 2012 në bazë të rezultateve nga një grup punues ndër-qeveritar, të kryesuar nga Ministria për Drejtësi, për t'i shqyrtuar rekomandimet nga raporti përfundimtar i vitit 2011 i MVZ-së së OSBE/ODIHR-së për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Amandamentet u miratuan me një shumicë të dobët në Kuvend (66 nga 123 anëtarë të parlamentit), ku partitë e opozitës u përmbajtën së votuari. Ndryshimet në shumicë kishën të bënin me financimin e fushatës, si dhe amandamente teknike për administrimin e zgjedhjeve lokale. Në plotësim të amandamenteve nga viti

---

3 Kjo përfshinte: kërkesë për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, reforma të Kodit Zgjedhor, shqyrtim të hollësishëm të listave të votuesve, dhe dorëheqjen e ministrave për Financa, Punë të Brenshme dhe Drejtësi, si dhe drejtorin ekzekutiv të transmetuesit publik, Radio Televizionit Maqedonas (RTM).

4 Teksti i marrëveshjes mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/commission_2010-2014/fule/headlines/news/2013/03/20130301_en.htm.

5 Në ndryshimet e Ligjit për Organizim Territorial të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në vitin 2008 u parapa bashkimi i komunave të Kërçovës, Zajazit, Osllomesë, Vraneshticës dhe Dërgovës në një komunë të vetme të quajtur Kërçovë. Ky amandament është efektiv që nga zgjedhjet lokale të vitit 2013, duke rezultuar në zvoglimin e numrit të komunave prej 84 në 80.

6 Tjera ligje të ndërlidhura janë Ligji për Veprimtari Radiodifuzive, Ligji mbi Partitë Politike, Ligji për Financimin e Partive Politike, Ligji për Nëpunësit Shtetëror, Ligji për Konfliktet Administrative, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Organizimin Territorial të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe Kodi Penal.

2012, Kodi Zgjedhor u ndryshua dy herë disa javë para zgjedhjeve, për ta vazhduar afatin për paraqitjen e kandidatëve. Ndryshimi i fundit vetëm e shtoi afatin skadues për dorëzimin e listave të kandidatëve deri më 8 mars dhe vlente vetëm për këto zgjedhje.[7] Afatet e tjera kohore në Kodin Zgjedhor nuk u ndryshuan për tu përputhur me vazhdimin e parë. Kjo krijoi konfuzion mes palëve të ndryshme lidhur me atë se kur duhet fushata zgjedhore zyrtarisht të fillojë.

Edhe pse nuk është praktikë e mirë që korniza ligjore të ndryshohet më pak se një vit para zgjedhjeve, ndryshimi i fundit u bë me konsensus gjithëpartiak.[8] Mirëpo, zgjatja e afatit për regjistrimin e kandidatëve vlente vetëm për partitë politike dhe koalicionet, dhe jo edhe për grupet e votuesve.[9] Kjo është në kundërshtim me parimet e përvijuara në paragrafet 7.5 dhe 7.6 të OSBE Dokumentit të Kopenhagës nga viti 1990, të cilat kërkojnë nga autoritetet që t'i respektojnë të drejtat e të gjithë kandidatëve për të garuar për poste publike pa kurrfarë diskriminimi.[10]

Edhe pse u bënë disa reforma sa i takon Kodit Zgjedhor lidhur me rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecisë) të Këshillit të Evropës, mbesin ende disa mangësi dhe dykuptimësi.[11] Kjo përfshin dispozita të detajuara për rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale, financimin e fushatës, regjistrimin e kandidatëve, dhe procesin e ankesave dhe parashtesave. Në plotësim, në Kodin Zgjedhor nuk është e rregulluar çështja për atë se si dhe kur kandidatët e pavarur dhe listat e partive mund të tërhiqen, gjë e cila krijoi polemika kur disa parti politike i tërhoqën listat e tyre pak kohë përpara zgjedhjeve. Në këtë kontekst, OSBE/ODIHR-ja e përshëndet marrëveshjen mes dy partive më të mëdha politike për të vazhduar me procesin e reformave elektorale pas këtyre zgjedhjeve.

Reformat e Kodit Zgjedhor duhet t'i trajtojnë rekomadimet e identifikuara në këtë raport, si dhe raportet paraprake të OSBE/ODIHR-së dhe Konventës së Venecisë. Rekomadohet që Kodit Zgjedhor t'i shtohen dispozita të qarta për rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale. Reformat duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përfunduara shumë kohë përpara organizimit të zgjedhjeve të ardhshme.

V. SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe këshillet komunale mbahen çdo katër vjet, në gjysmën e dytë të muajit mars. Secila prej 80 komunave dhe Qyteti i Shkupit zgjedhin kryetar komune dhe këshill komunal. Kryetarët e komunave zgjidhen sipas modelit të shumicës që përbëhet nga dy rrethe. Për tu zgjedhur kryetar komune në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë më shumë se 50 përqind të votave.

---

7 Amandamenti kaloi me atë që 82 anëtarë votuan në favor të tij dhe një ishte kundër. Ishte hera e parë që nga 24 dhjetori që LSDM-ja dhe partitë e tjera opozitare të kthehen në Kuvend.

8 Kodi i Praktikave të Sjelljes së Mirë lidhur me Çështjet Elektorale i Komisionit të Venecisë rekomandon që "elementet fundamentale të Kodit Zgjedhor […] të mos ndryshohen më pak se një vit para zgjedhjeve". http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD%282002%29023rev-e.aspx.

9 MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së është e vetëdishme për së paku një rast, edhe atë në komunën e Çuçer Sandevës, ku një grupi votuesish, lista e të cilëve fillimisht u rrefuzua për shkak të dorëzimit të vonshëm nuk iu lejua regjistrim me afatin e ri kohor.

10 Paragrafi 7.5 i OSBE Dokumentit të Kopenhagës thotë se shtetet pjesëmarrëse duhet ta "respektojnë të drejtën e qytetarëve për të kërkuar post politik ose publik, individualisht ose si përfaqësues të partive politike ose organizatave, pa kurrfarë diskriminimi." Paragrafi 7.6 më tej përcakton se shtetet pjesëmarrëse duhet "tu sigurojnë partive politike dhe organizatave garancionet e nevojshme ligjore për t'i mundësuar ato të garajonë njëri me tjetrin në bazë të trajtimit të barabartë përpara ligjit dhe nga autoritetet."

11 Mendimi i Përbashkët për Kodin Zgjedhor të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë i OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit të Venecisë, Nr. 640/2011, CDL-AD(20011)027, i qasëshëm në http://www.osce.org/odihr/84226.

Gjithashtu, që zgjedhjet të jenë valide ka edhe kriter i cili kërkon që në rrethin e parë të kenë votuar së paku një e treta e votuesve të regjistruar në listën e votuesve. Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk përcakton se çfarë ndodh nëse nuk përmbushet kriteri për dalshmërinë e votuesve në rrethin e parë. Nëse asnjëri prej kandidatëve nuk fiton në rrethin e parë, organizohet rrethi i dytë në mes dy kandidatëve të cilët e kanë fituar shumicën e votave në rrethin e parë. Për rrethin e dytë të zgjedhjeve nuk ka kriter për dalshmërinë e votuesve.

Kodi Zgjedhor duhet të përcaktojë se çfarë ndodh me zgjedhjet lokale atëherë kur në rrethin e parë numri i votuesve është më i vogël se një e treta e votuesve të regjistruar.

Këshilltarët komunalë zgjidhen sipas modelit të përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura. Vendet përcaktohen duke përdorur formulën e *d'Hondt-it*. Nuk ka kusht për përqindjen e votuesve që kanë dalë në zgjedhje. Numri i këshilltarëve që zgjidhen për çdo komunë varet nga numri i banorëve në çdo komunë, duke lëvizur prej 9 deri më 33 anëtarë. Në Kushtetutë përcaktohet se Qyteti i Shkupit është njësi e posaçme e vetëqeverisjes lokale e cila përbëhet nga dhjetë komuna, kështu që në Shkup votuesit e zgjedhin këshillin e tyre individual dhe një të posaçëm i cili përbëhet nga 45 anëtarë të këshillit për Qytetin e Shkupit.

VI. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet lokale u administruan nga administrata zgjedhore e organizuar në tre nivele, që përbëhet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni Zgjedhor për Qytetin e Shkupit, si dhe 2,976 këshilla zgjedhorë (KZ). Për rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale, numri i KZ u zvoglua në 1,614, duke reflektuar numrin e garave në rrethin e dytë, të administruara nga 32 KZK.

KSHZ-ja është organ i përhershëm që është përgjegjës për realizimin e gjithëmbarshëm të zgjedhjeve. Përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga Kuvendi me shumicë prej dy të tretave, me mandat katërvjeçar.[12] Kryetari i KSHZ-së dhe dy anëtarë të tij emërohen nga partitë opozitare, ndërsa nënkryetari dhe tre anëtarë emërohen nga partitë në pushtet.

KSHZ-ja e përmbushi shumicën e afateve kohore zgjedhore dhe funksionoi në mënyrë efikase. Seancat e KSHZ-së ishën të hapura për vëzhguesit e akredituar dhe për mediat. Vendimet e tyre dhe shumica e procesverbaleve të seancave u publikuan në ueb faqen e KSHZ-së, gjë e cila është në përputhje me një rekomandim më të hershëm të OSBE/ODIHR-së. Në plotësim, disa çështje siqë janë dizajnimi dhe shtypja e fletëvotimeve u diskutuan në takime të mbyllura joformale mes anëtarëve të KSHZ-së.

KSHZ-ja duhet më tej ta avancojë transparencën e saj duke e respektuar rreptësisht kërkesën për publikimin e të gjitha procesverbaleve të takimeve në ueb faqen e saj. Kodi Zgjedhor mund të plotësohet për të përcaktuar se procesverbalet duhet të publikohen jo më vonë se 48 orë pasiqë të mbahet seanca.

Disa vendime, në veçanti ato të ndërlidhura me tërhekjen e listave të kandidatëve dhe ankesat për ditën e zgjedhjeve u votuan përgjatë vijave partiake dhe etnike, dhe jo karakteristikave ligjore të çështjes. Kjo

[12] Anëtarët aktual të KSHZ-së u emëruan në vitin 2011, pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Një e treta e anëtarëve të KSHZ-së janë femra.

ndikoi në mënyrë negative mbi paanshmërinë dhe kolegialitetin e KSHZ-së.

KSHZ-ja duhet t'i zgjedhë të gjitha ankesat dhe parashtesat në mënyrë të paanshme pa peshën e konsideratave të motivuara në mënyrë politike. Ligji duhet të interpretohet, zbatohet dhe përforcohet sipas qëllimeve të vetë ligjit.

KSHZ-ja përgatiti një manual gjithëpërfshirës për KZK dhe KZ, në të cilin u përvijuan procedurat e votimit, numërimit dhe grumbullimit të rezultateve. KSHZ-ja përgatiti disa TV spote edukative për votuesit, të cilat u transmetuan përpara rrethit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve. Përndryshe, kishte një mungesë evidente të materialeve për edukimin e votuesve.

KSHZ-ja duhet të sigurojë më tepër informata dhe edukim për votuesit, në veçanti sa i takon kohës dhe procedurave për freskimin e të dhënave personale në listën e votuesve, dhe për fshehtësinë e votës.

KZK-të janë përgjegjëse për mbikqyrjen e procesit zgjedhor në çdo komunë dhe detyrat e tyre përfshijnë regjistrimin e kandidatëve, emërimin dhe trajnimin e KZ-ve, grumbullimin dhe shpalljen e rezultateve komunale, si dhe përgatitje të tjera teknike nën lidershipin e KSHZ-së. Ato përbëhen nga një kryetar, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre dhe emërohen për një periudhë katër vjeçare.[13] Anëtarët e KZK-së zgjidhen në mënyrë të rastësishme nga KSHZ-ja, nga radhët e të punësuarve me arsim të lartë në administratën shtetërore dhe atë lokale. Çdo KZK përkrahet nga një sekretar dhe një zëvendës të emëruar nga kryetari i KZK-së nga rradhët e juristëve të diplomuar. Të gjithë anëtarët e KZK-së dhe zëvendësit e tyre duhet me vendbanim të jenë nga komuna respektive. Disa KZK u ballafaquan me problem financiar për shkak se komunat nuk ua kishën siguruar në kohë fondet e nevojshme për administrimin e zgjedhjeve. Në disa raste anëtarët e KZK-ve i përdornin fondet e tyre personale.[14] Sidoqoftë, mungesa e fondeve me sa dukeshte nuk ndikoi në përgatitjen e zgjedhjeve. Disa KZK nuk i paralajmëruan seancat e tyre para kohe dhe sollën vendime në takime joformale, dhe me këtë e zvogluan transparencën e punës së tyre.

Rekomandohet që KZK-ve tu sigurohen resurset e nevojshme në kohë. Në plotësim, transparenca e punës do të rritet nëse KZK mbajnë vetëm seanca publike, të cilat do të paralajmërohen para kohe.

KZ-të janë përgjegjëse për zbatimin e procedurave në ditën e zgjedhjeve në kuadër të vendvotimeve. KZ-të përbëhen nga pesë anëtarë: një kryetar, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre, dhe emërohen për një periudhë katër vjeçare. Një anëtar dhe zëvendës emërohen nga partitë politike në pushtet, një anëtarë dhe zëvendës nga partitë opozitare, dhe tre anëtarë dhe zëvendësit e tyre janë në mënyrë të rastësishme të zgjedhur nga nëpunësit shtetëror.[15] Të gjithë anëtarët e KZ-ve u trajnuan nga KZK-të. Në disa raste, KZK-të vendosën të organizojnë trajnime shtesë për KZ-të, për t'i adresuar disa prej problemeve të hasura në rrethin e parë të zgjedhjeve, duke përfshirë edhe përfundimin e protokoleve të rezultateve. Shumica e KZ-ve i kryen detyrat e tyre mirë gjatë të dy rretheve të zgjedhjeve edhe pse shpallja e

---

13 KZK-të aktuale janë të emëruara më 26 prill 2011.

14 Që nga shtatori i vitit 2012, KSHZja dërgoi më tepër se 20 shkresa në Qeveri, Kuvend dhe kryetarëve të komunave për të kërkuar ndihmë financiare për 25 komuna. Disa KZK e informuan MVZ e OSBE/ODIHR-së se ato nuk kanë marrë para nga komunat dhe se pagimi i KZ-ve do të bëhet vetëm pas përfundimit të rrethit të dytë të zgjedhjeve.

15 KZ-të aktuale janë emëruar më 1 shkurt 2013, duke përfshirë edhe anëtarët e emëruar nga partitë politike.

rezultateve paraprake u vonua në disa komuna.[16]

Mes dy rretheve KSHZ-ja e shkarkoi KZK dhe 13 KZ në Çair për shkak të dyshimeve për falsifikim të rezultateve zgjedhore. Rasti hetohet nga Zyra e Prokurorit. Disa bashkëbisedues të MZV-së së OSBE/ODIHR-së ishën të brengosur për atë se për shkak të mungesës për kualifikime minimale për përzgjedhjen e anëtarëve të KZ, shpesh ndodh që njerëz me arsim të pamjaftueshëm të emërohen në KZ.

Duhet të konsiderohet organizimi frekuent dhe më i detajuar i trajnimeve për anëtarët e KZ-ve.

Kodi Zgjedhor parasheh përfaqësimin e drejtë etnik dhe gjinor në të gjitha organet e administratës zgjedhore.[17] Përbërja etnike e KZK-ve dhe KZ-ve u vëzhgua në mënyrë të përpiktë dhe përfaqësimi gjinor në shumicë u respektua.[18]

VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Të gjithë qytetarët me vendbanim të regjistruar në komunën respektive, të cilët i kanë mbushur 18 vjet dhe kanë dokument valid për identifikim kanë të drejtë të votojnë, përveç atyre të cilëve u është marrë e drejta e votës me vendim gjyqësor. Qytetarët të cilët përkohësisht jetojnë jashtë vendit janë të regjistruar në listën e votuesve në pajtim me vendbanimin e tyre të fundit. Për herë të parë në këto zgjedhje, në listën e votuesve u përfshinë vetëm ato qytetarë të cilët posedojnë letërnjoftim ose pasaportë biometrike.[19]

KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e listave zgjedhore të votuesve duke u bazuar në informatat e nxjerra nga regjistri civil, që mbahet nga Ministria për Punë të Brendshme (MPB). Në vitin kur mbahen zgjedhje, MPB-ja bën freskimin e listave të votuesve ditën pas shpalljes së datës së zgjedhjeve.[20] Në datën e njejtë gjykatat themelore i dorëzojnë KSHZ-së të dhëna për personat të cilëve u është marrë kapaciteti i tyre ligjor me vendim gjyqësor. Në plotësim, Ministria e Drejtësisë (MD) i mundëson informata të rregullta për të sapolindurit, të vdekurit dhe për martesat.

Detyrat e 132 zyrave regjistruese civile të MD-së, 30 zyrat e MPB-së and 34 zyrat rajonale të KSHZ-së nuk janë qartësisht të përcaktuara lidhur me freskimin e të dhënave në listat e votuesve, dhe shpesh duket se pjesërisht janë duke u përputhur. MD-ja dhe MPB-ja kanë zbatuar disa kontrolla administrative të të dhënave lidhur me të vdekurit dhe të dhënat e qytetarëve të regjistruar që nga viti 2010. Sipas MD, MPB dhe Entit Shtetëror Statistikor, listat e votuesve janë të saktë në kuadër të mundësive që i ofron kapaciteti aktual teknologjik.

---

16 Sipas Nenit 135(1) të Kodit Zgjedhor, KZK-të kanë shtatë orë që nga mbyllja e vendvotimeve për t'i shpallur rezultatet për komunën e tyre. Dyzet e një komuna dështuan për ta përmbushur afatin kohor për t'i shpallë rezultatet e parakohshme.

17 Sipas Nenit 21 nga Kodi Zgjedhor, bashkësitë etnike të cilat përbëjnë më tepër se 20 përqind nga popullata në një komunë duhet të përfaqësohen në KZK-të dhe KZ-të, ndërsa së paku 30 përqind nga anëtarët në të gjitha organet zgjedhore duhet të jenë nga të dy gjinitë.

18 Nuk ka sankcione në raste kur kriteri gjinor nuk përmbushet.

19 Sipas Ligjit për Letërnjoftime dhe Ligjin për Dokumente Udhëtuese, që nga 1 prill 2012 dokumentet e vetme valide janë letërnjoftimet dhe pasaportat biometrike.

20 Spikeri i Kuvendit i shpalli zgjedhjet lokale më 11 janar 2013.

Duhet të konsiderohet zbatimi i një shqyrtimi të procedurave për grumbullimin dhe mirëmbajtjen e listave të votuesve. Procedurat e qarta, të koordinuara dhe transparente do ta shtojnë saktësinë e listave të votuesve dhe do të kontribuojnë në besimin publik.

Votuesit mund t'i kontrollojnë listat e votuesve në një nga 34 zyrat rajonale të KSHZ-së dhe mund të kërkojnë plotësime, shlyerje dhe ndryshime përgjatë tërë vitit. Votuesit mund gjithashtu të kontrollojnë se a janë në listat e votuesve duke përdorur një aplikacion interneti. Garuesit në zgjedhje kishën mundësi që nga KSHZ-ja të kërkojnë kopje të listave të votuesve në letër apo në formë elektronike, dhe të dorëzojnë kërkesa të përmbajtura për t'i ndryshuar listat e votuesve. Në pajtim me ligjin, e disponueshme ishte edhe një periudhë për kontrollë publike të listave të votuesve nga 26 janar deri më 9 shkurt 2013, dhe rreth 43,633 njerëz i kontrolluan listat nëpër gjithë shtetin, ku 1,788 votues u shtuan në listat e votuesve. Listat e votuesve u mbyllën 15 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Sipas KSHZ-së, gjithsej 1,743,403 qytetarë janë regjistruar për të votuar në këto zgjedhje.

Sipas MPB-së, rreth 119,000 njerëz janë shlyer nga listat e votuesve përpara këtyre zgjedhjeve për shkak të mosposedimit të letërnjoftimit ose pasaportës biometrike. Ky pastrim i listave votuese u përkrah nga të gjitha partitë. Sidoqoftë, me afrimin e ditës së zgjedhjeve, partitë politike shprehën brengat e tyre të kahmotshme për saktësinë e listave të votuesve. Më 22 mars, LSDM-ja inicoi një peticion në KSHZ, duke e sfiduar prezencën e 13,869 votuesve në listat e votuesve. MPB-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-së se KSHZ-ja i ka dhënë 847 emra të përfshira në peticionin e LSDM-së për verifikim, dhe konfirmuan se këto emra janë kontrolluar në hollësi dhe se të gjithë ishën votues legal.[21] Ankesat e tjera lidhur me saktësinë e listës së votuesve në përgjithësi nuk ishën të përmbajtura.

Tridhjetë e nëntë votues të cilët nuk ishën në listat e votuesve në rrethin e parë të zgjedhjeve dorëzuan ankesa në KSHZ, duke kërkuar që ato të përfshihen në listat në rrethin e dytë. KSHZ-ja vendosi që mos i shqyrtojë ankesat deri në përfundim të zgjedhjeve, duke deklaruar se Kodi Zgjedhor i parandalon ato që t'i ndryshojnë listat e votuesve në mes dy rretheve zgjedhore. Më 2 prill, KSH-ja në një seancë të gjatë dhe të kontestueshme vendosi që mos i lejojë qytetarët të cilët kanë pasaporta biometrike, në të cilat e kanë të shënuar Republikën e Shqipërisë si adresë të tyre, të votojnë në rrethin e dytë edhe pse ato ishën të përfshirë në listat e votuesve dhe u lejuan që të votojnë në rrethin e parë.

Duhet të konsiderohet një ndryshim i afatit kohor për finalizimin e listave të votuesve me qëllim që i njejti të jetë më afër ditës së zgjedhjeve.

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Në plotësim të kushtit i të qenit votues, ligji kërkon që kandidatët të jenë banorë në komunën në të cilën ato duan të garojnë në zgjedhje. Në zgjedhjet lokale mund të garojnë kandidatë të emëruar nga parti politike, koalicione të partive politike, ose kandidatë të pavarur të emëruar nga një grup i votuesve. Nga kandidatët e pavarur kërkohet që ta përkrahin kandidaturën e tyre me 100 dhe 450 nënshkrime, varësisht nga madhësia e komunës, dhe me së paku 1,000 nënshkrime në Qytetin e Skupit. Mbledhja e nënshkrimeve zgjat 15 ditë dhe nënshkrimet përkrahëse mund të vijnë vetëm nga votues me të drejtë vote të cilët banojnë në komunën respektive. Një votues mund të nënshkruhet si përkrahës vetëm në një

[21] LSDM-ja sqaroi në peticion se këto votues nuk ishën në listat e votuesve në vitin 2011 dhe siguroi shembuj të shumë votuesve të cilët ishën të paraqitur në adresën e njejtë; në një rast në komunën Qendër të Shkupit 75 persona ishën të regjistruar në adresën e njejtë. KSHZ-ja vendosi të bëjë kërkesë tek MPBja për të sqaruar se "sipas cila kushteve, procedurave dhe kur" këto votues kanë marrë nënshtetësi, dhe dokumentet e tyre për identifikim.

listë. Partitë politike dhe koalicionet e regjistruara janë të liruara nga mbledhja e nënshkrimeve për shkak se ato dorëzojnë dokumente për regjistrimin e partisë, dhe në rast nevoje një deklaratë për konfirmimin e statusit të koalicionit.

Listat e kandidatëve duhet të dorëzohen në KZK jo më vonë se 35 ditë përpara ditës së zgjedhjeve dhe KZK-të janë përgjegjëse për miratimin dhe regjistrimin e listave. Në komunat në të cilat më tepër se 20 përqind e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga ajo maqedonase, listat e kandidatëve mund të dorëzohen në atë gjuhë. Renditja e listave të kandidatëve në fletvotimin u përcaktua nga KSHZ-ja, në bazë të një lotarie. Çdo liste të kandidatëve iu dha numri i njejtë për të gjitha komunat.[22]

Në përgjithësi, regjistrimi i kandidatëve ishte përfshirës dhe u siguroi votuesve përzgjedhje të ndryshme.[23] Gjithsej, 350 lista për kryetar komune dhe 480 lista për këshille u dorëzuan nga 16 parti politike, 8 koalicione dhe 97 grupe të qytetarëve. Në pajtim me kërkesat ligjore, një kandidat në çdo tre vende në një listë të kandidatëve ishte i rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar. Për dallim të zgjedhjeve paraprake, kur asnjëra prej femrave nuk u zgjodh për kryetar komune, në këto zgjedhje 4 nga 32 femra kandidate u zgjodhën.

Janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për rritjen e numrit të kandidatëve femra. Duhet të konsiderohet ndryshimi i Nenit 64.5 nga Kodi Zgjedhor, ku i njejtë do të përcaktojë se në rast se një femër e zgjedhur nga një listë e kandidatëve për këshillin komunal jep dorëheqje, e njejta do të zëvendësohet nga femra e ardhshme në listë.

Pasiqë LSDM-ja hoqi dorë nga bojkotimi i zgjedhjeve, VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja vendosën të dorëzojnë listë të përbashkët të kandidatëve në Kërçovë dhe Strugë, ku priteshin garime të nxehta mes garuesve etnik shqiptarë dhe maqedonsë. Meqenëse lista e VMRO-DPMNE-së më ishte e regjistruar nga KZK-të respektive, VMRO-DPMNE kërkoi nga KSHZ-ja tu lejojë atyre që t'i tërhekin listat e tyre të kandidatëve në këto dy komuna. KSHZ-ja vendosi ta lejojë tërhekjen e listave mirëpo vendimi nuk u pranua nga dy KZK-të të cilat më pas i rrefuzuan listat e përbashkëta të dorëzuara nga LSDM-ja për shkak se të njejtat përmbanin kandidatë të cilët më ishën në listën e verifikuar të VMRO-DPMN-së.[24] LSDM-ja apeloi vendimin për rrefuzimin e listave të përbashkëta në Gjykatën Administrative, e cila e anuloi vendimin e dy KZK-ve më 9 mars. Listat e përbashkëta të LSDM-së pastaj u pranuan. BDI-ja dhe PDSH-ja e vënë në pyetje legalitetin e vendimit gjyqësor, duke pohuar se KSHZ-ja nuk ka autoritet që ta miratojë tërhekjen e listave njëherit që të njejtat janë verifikuar nga KZK-të.[25]

Kodi Zgjedhor mund të përfshijë dispozita specifike lidhur me kohën dhe kushtet për tërhekjen e listave të regjistruara të kandidatëve. Mund të shqyrtohet edhe krijimi i mundësisë që një listë e kandidatëve të miratohet pjesërisht (për shembull, të pranohen vetëm emrat e kandidatëve në listë të cilët i përmbushin kriteret ligjore dhe të tjerët të fshihen nga lista). Nëse dispozitat inicohen,

---

22 Nëse një listë e kandidatëve nuk ishte e regjistruar në një komunë të caktuar, numri i tyre nga lista nuk shënoheshte.

23 Gjithsej 8,878 kandidatë u regjistruan në zgjedhjet lokale 2013, një ulje prej gjithsej 13,079 kandidatë të regjistruar për zgjedhjet lokale të vitit 2009.

24 Neni 57(2) i Kodit Zgjedhor ndalon cilin do kandidat që të paraqitet në dy lista të ndryshme. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së u informua se listat e LSDM-së në Strugë dhe Kërçovë përmbanin 12 nga 13 kandidatë të cilët respektivisht më ishën në listën e VMRO-DPMNE-së.

25 KSHZ-ja konkludoi në një seancë paraprake të mbajtur më 4 mars se nuk ka dispozita ligjore të cilat e lejojnë atë të ndryshojë një listë të kandidatëve, njëherit që e njejta është regjistruar nga KZK. Procesverbali i seancës së KSHZ-së është i disponueshëm në: http://www.sec.mk/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=42&Itemid=103.

rekomandohet që të krijohen mekanizma për mbrojtje që të mos keqpërdoret e drejta për tërhekjen e listave të kandidatëve.

IX. FUSHATA ZGJEDHORE

Në pajtim me Kodin Zgjedhor, fushata zgjedhore filloi zyrtarisht me 4 mars dhe për rrethin e parë mbaroi në mesnatë më 22 mars, ndërsa për rrethin e dytë më 5 prill. Në kundërshtim me dispozitat ligjore, disa kandidatë mbajtën aktivitete promovuese përpara fillimit të periudhës së fushatës.[26]

E tërë fushata zgjedhore ishte konkurruese dhe kandidatët kishën mundësi të bëjnë fushatë pa pengesa. Dukshmëria e materialeve të fushatës ishte modeste, mirëpo u zmadhua shumë në dhjetë ditët e fundit përpara ditës së parë të zgjedhjeve. Billbordet, afishet dhe posterët u vendosën përpara rrethit të parë, dhe materiale të reja promovuese u vendosën në disa komuna përpara rrethit të dytë. Përderisa autoritetet në përgjithësi e përmbushën detyrën e tyre për të alokuar vend për materialet promovuese, në disa komuna kandidatëve nuk ju dha e njejta mundësi ose po nuk u informuan për të.

Përderisa shumë kandidatë mbajtën tubime me prezencë shumë të mirë nëpër gjithë vendin përpara rrethit të parë të zgjedhjeve, ato të cilët garonin në rrethin e dytë zgjodhën takime më të vogla me votuesit, konferenca shtypi, dhe fushatë prej dere në derë.[27] Shumica e garuesve në zgjedhje për t'i përfshirë votuesit, gjithashtu përdorën internetin, duke përfshirë mediat sociale. Në rrethin e parë kandidatët synonin votuesit nga bashkësia e tyre etnike, në rrethin e dytë kandidatët shpesh e kërkuan përkrahjen e votuesve jashtë bashkësisë së tyre etnike, edhe atë në zgjedhjet mes kandidatëve të bashkësisë së njejtë etnike.[28] Gjatë të dy rretheve zgjedhore, VMRO-DPMNE-ja e gëzonte dukshmërinë më të madhe në vendet e banuara kryesisht nga maqedonasit etnik, ndërsa BDI-ja ishte më shumë e dukshme atje ku shqiptarët etnik përbëjnë shumicën.

Krizat e fundit politike e acaruan retorikën e fushatës dhe përdorimi i retorikës përçarëse etnike rezultoi në tensione të nxehura në kontekst intra-etnik dhe ndër-etnik. Protestat e dhunshme lidhur me emërimin e Talat Xhaferrit si ministër të ri të Mbrojtjes në fillim të periudhës së fushatës rezultuan në atë që disa parti politike të akuzohet ndërmjetësisht për nxitjen e tensioneve etnike, duke e shtyer bashkësinë ndërkombëtare dhe grupet vendore të shoqërisë civile të apelojnë për qetësi në prag të zgjedhjeve. Në përpjekje për të promovuar një atmosferë pozitive të fushatës, kandidatët në Shkup dhe në disa komuna të tjera, nënshkruan një Kod të Sjelljes së Mirë në përkrahje të një fushate paqësore dhe korrekte.

Edhe pse aktivitetet e fushatës në përgjithësi ishën të qeta, disa raste të vandalizimit të shtabeve zgjedhore, materialeve promovuese të dëmtuara ose të hekura, dhe sulme fizike u vërejtën nëpër gjithë

---

26 MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së vërejti disa ngjarje më 2 mars, duke përfshirë një në Kërçovë (BDI) dhe në Shtip (VMRO-DPMNE), në të cilat u prezantuan programet zgjedhore të kandidatëve. Në plotësim, për shkak të afatit të vazhduar për regjistrim të kandidatëve, LSDM-ja dhe partitë e tjera opozitare e filluan fushatën përpara verifikimit të listave të tyre nga ana e KZK-ve.

27 MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së vëzhgoi 54 tubime përpara rrethit të parë të zgjedhjeve dhe 2 përpara rrethit të dytë të zgjedhjeve.

28 Kandidati i PDSH-së u përpoq që t'i tërhekë votuesit e maqedonasve etnik në Tetovë; kandidati i BDI-së Nevzat Bejta BDI i përfshiu maqedonasit etnik në Gostivar; kandidatët e LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së u drejtuan tek elektorati i shqiptarëve etnik në Kumanovë dhe Veles.

vendin gjatë të dy rretheve të fushatës.[29] Tonacioni i fushatës u bë më i ashpër në prag të rrethit të dytë. Mesazhe promovuese negative dhe anonime u shfaqën në media, si dhe në postera dhe fletushka në disa komuna.[30] Një numër i kandidatëve gjithashtu paraqitën aktivitete mashtruese nga ana e kundërshtarëve të tyre gjatë rrethit të parë. Në plotësim, shqetësimet për frikësimin e votuesve, në veçanti ndaj të punësuarve në sektorin publik, vazhduan gjatë gjithë periudhës së fushatës. Megjithatë, partitë politike nuk dorëzuan ankesa formale, as po prezantuan dëshmi zyrtare përpara autoriteteve relevante për t'i përkrahur këto shqetësime përpara ditës së zgjedhjeve. Pavarësisht të saktësisë së këtyre akuzave, përhapshmëria e tyre e mjegulloi besimin në drejtësinë e procesit zgjedhor dhe i ngriti shqetësimet për mundësinë e votuesve për ta dhënë votën e tyre "lirshëm pa mos pasur frikë nga pasojat," siqë kërkohet në paragrafin 7.7 të OSBE Dokumentit të Kopenhagës nga viti 1990.[31]

Me qëllim që më tej të përforcohet besimi publik në procesin zgjedhor dhe të sigurohet një mjedis i hapur për të bërë fushatë, autoritetet relevante duhet të ndërmarrin iniciativa më të mëdha për hetimin adekuat të akuzave për frikësimin e votuesve, dhe të ndërmarrin veprime adekuate në rast të dëshmimit të shkeljes së të njejtës.

Indikimet për keqpërdorimin e resurseve shtetërore mbisunduan gjatë tërë fushatës, duke përfshirë edhe vendosjen e materialeve promovuese nga ana e partive qeveritare në pronë shtetërore, edhe atë shtyllat e dritave rrugore, ndërtesat publike dhe urat, gjë e cila është në kundërshtim me Nenin 82 të Kodit Zgjedhor.[32] MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së gjithashtu vërejti raste në të cilat zyratarët qeveritarë dhe ministrat po bënin fushatë aktive për kandidatët e partive të tyre, shpesh gjatë orarit të punës dhe duke përdorur vetura zyrtare.[33] Në disa raste, ministrat e kushtëzuan përkrahjen për projektet lokale nga ana e

---

29 Duke përfshirë edhe shtabin e kandidatit për kryetar komune në Karposh, Stevçe Jakimovski nga Partia Progresive Serbe (PPS), si dhe shtabet e BDI-së në Kërçovë dhe të LSDM-së në Ohër, Strumicë dhe Gostivar. Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-së raportuan se gati gjysma e posterëve të listave të pavarura të cilat garonin për kështillet janë shkatërruar në Kumanovë, ndërsa një numër i madh i posterëve të të gjitha partive ishën të shkarravitura nëpër gjithë vendin. Në plotësim, Ajduvan Mamudov, udhëheqës i shtabit zgjedhor të kandidatit Nexhdet Mustafa (Forcat e Bashkuara Demokratike të Romëve) u sulmua më 20 mars dhe rasti është ende nën hetim.

30 Për shembull, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së vërejti fletushka me përmbajtje negative kundër kandidatit të LSDM-së Andrej Zhernovski (nuk ka burim të cituar) në Shkup, dhe postera me përmbajtje negative për një kandidat të pavarur në Mogillë, të cilat përmbanin të dhëna të stampuara për VMRO-DPMNE. Gjatë vizitës së Kryeministrit Nikolla Gruevski në Mogillë më 30 mars, kandidati i pavarur u përshkrua si bashkëpunëtor i Velija Ramkovskit, pronarit të televizionit A1 i cili tani është jashtë funksioni, i cili është është i dënuar me burg për fshehje tatimi.

31 Paragrafi 7.7 i OSBE Dokumentit të Kopenhagës nga viti 1990 thotë se shtetet pjesëmarrëse "do të mundësojnë që ligji dhe politika publike të funksionojnë në atë mënyrë që të lejojnë që bërja e fushatës politike të zbatohet në një atmosferë të drejtë dhe të lirë, në të cilën as veprimi administrativ, as dhuna e as frikësimet i pengojnë partitë dhe kandidatët që lirisht t'i prezantojnë pikëpamjet dhe kualifikimet e tyre, as po i pengon votuesit që të mësojnë dhe të diskutojnë për ata, ose nga dhënia e votës së tyre pa frikë nga pasojat."

32 Materiale promovuese të vendosura në prona publike mes tjerave u vërejtën në Veles, Shtip, Strumicë, Demir Hisar, dhe Vevçan. Në Butel, flamujt e VMRO-DPMNE-së u shmangën nga shtyllat e dritave rrugore pas protestimit të LSDM-së.

33 Më 15 mars në Shtip, Kryeministri dhe ministri i Shëndetësisë ishën prezent në inaugurimin e një objekti të ri shëndetësor, të organizuar nga ana e autoriteteve lokale, gjatë të së cilit kandidati i VMRO-DPMNE-së prezantoi pjesë të programit të tij zgjedhor; më 1 prill Kryeministri e vizitoi Dellçevën për të prezantuar një projekt për zonë industriale së bashku me kryetarin e komunës së qytetit nga radhët e VMRO-DPMNE-së, gjithashtu më 1 prill, Kryeministri bënte fushatë për kryetarin e komunës dhe kandidatët të VMRO-DPMNE-së në Berovë. Në raste të tjera, disa ministra gjithashtu i vizituan komunat e Jegunovcit dhe Berovës, për të bërë fushtë në emër të kandidatëve të VMRO-DPMNE-së. Duhet të theksohet se ministrat qeveritar të BDI-së, të cilët ishën prezent në evenimentet parazgjedhore, në përgjithësi mbetën pasiv dhe nuk dolën në skenë për t'i përkrahur kandidatët e partisë së tyre.

pushtetit qendror me rezultatet e zgjedhjeve lokale.[34] Në plotësim, Qeveria bëri disa shpallje shumë mirë të promovuara për vende të lira pune, si dhe rritje të pensioneve, ndihmave sociale dhe përkrahje qeveritare për prodhime bujqësore gjatë rrethit të parë të fushatës. Pak përpara rrethit të dytë të votimeve, Qeveria shpalli një plan të madh për riparimin dhe ndërtimin e shkollave të reja nëpër gjithë vendin, duke përfshirë edhe disa komuna në të cilat kandidatët e partive qeveritare po garonin. Bashkarisht, këto instanca të përzierjes së kufirit mes partisë dhe shtetit rrisin shqetësimet për nivelin e garimit për kandidatët, dhe janë në kundërshtim me paragrafin 5.4 të OSBE Dokumentit të Kopenhagës nga viti 1990.[35]

Autoritetet duhet të shfaqin vullnet më të madh politik për të mundësuar dallim të mjaftueshëm mes shtetit dhe partisë. Garancionet ekzistuese ligjore, siqë është Neni 8-a dhe 9 nga Kodi Zgjedhor, duhet të interpretohen në një mënyrë konzistente me qëllim që të parandalohet konflikt interesash mes pozitave të pushtetit ekzekutiv, të cilat kërkojnë neutralitet, dhe kandidatëve të cilët aspirojnë avantazh politik. Dispozitat duhet më tej të plotësohen për të përfshirë mekanizma për detyrim.

Sa u takon zhvillimeve pozitive, disa kandidatë të BDI-së, partner në koalicionin qeveritar, të cilët mbanin pozita zyrtare dhanë dorëheqje përpara fillimit të fushatës.[36]

X. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushtës rregullohet me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Financimin e Partive Politike.[37] Të gjithë garuesit në zgjedhje janë të detyruar të hapin xhiro-llogari të posaçme bankare për donacionet e fushatës dhe shpenzimet, dhe të japin raporte me detajet e financimit të fushatës. Ky kusht u përmirësua me amandamentet e vitit 2012 në Kodin Zgjedhor, të cilat kërkojnë që çdo garues në zgjedhje të marrë një numër të vetëm për tatim, me qëllim që ta hapi xhiro-llogarinë e tij bankare. Amandamentet më tej sqarojnë se të mirat dhe shërbimet e shitura me çmime me lëshim duhet të evidentohen si donacione xhentilësie, dhe duhet të llogariten sipas çmimit të tregut. Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit i Këshillit të Evropës (GRECO) në Raportin për Përputhshmëri për vitin 2012, e shënoi këtë ndryshim si një gjë pozitive.

Financimi i fushatës në shumicë mbështetet në taksat e anëtarësisë dhe donacionet. Limiti ligjor për donacione nga individë është 5,000 euro, ndërsa limiti për persona juridik është 5 përqind nga të ardhurat e tyre në vitin e kaluar. Donacione nga burime të huaja dhe publike nuk mund të pranohen.

Siqë është rekomanduar paraprakisht, dallimi në natyrën e limiteve mes individëve dhe personave

[34] Për shembull, gjatë tubimit të VMRO-DPMNE-së për mbështetjen e kandidatit për kryetar komune në Jegunovcë, Kryeministri theksoi se komuna do të humb disa fonde nga pushteti qendror nëse për kryetar komune zgjidhet kandidati i LSDM-së. Argumente të ngjajshme u bënë nga kandidatët e koalicionit qeveritar në Gostivar, Kratovë, Kumanovë dhe Tetovë. Në rastin e kundërt, kandidati i PDSH-së në Tetovë promovonte arritjet e tij si kryetar i komunës së Tetovës edhe përpos të mungesës së përkrahjes nga pushteti qendror për një komunë të qeverisur nga një politikan i PDSH-së. Tre kryetarë komunash nga LSDM-ja u ankuan tek MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së për neglizhencën e pushtetit qendror dhe pengimin e projekteve të tyre në të kaluarën, gjë e cila e ka dëmtuar mundësinë e tyre për të garuar në baza të barabarta me kandidatët e partive qeveritare.

[35] Paragrafi 5.4 i OSBE Dokumentit të Kopenhagës nga viti 1990 parashikon "një ndarje të qartë mes shtetit dhe partive politike; në veçanti që partitë politike mos ngatërrohen me shtetin."

[36] Kandidatët e BDI-së Teuta Arifi (zëvendës kryeministër), Nevzat Bejta (ministër i Vetëqeverisjes Lokale) dhe Arben Labenishti (deputet në Kuvend), dhanë dorëheqje nga postet e tyre për të garuar për kryetarë komunash.

[37] Ligji për Financimin e Partive Politike u ndryshua më 9 nëntor 2012, në përputhshmëri me ndryshimet në Kodin Zgjedhor.

juridik duhet të rishqyrtohet. Dispozitat aktuale janë diskriminuese, dhe u japing avantazh të padrejtë entiteteve të mëdha.

Shpenzimet e fushtës kufizohen në 180 denarë (3 euro) për çdo votues të regjistruar në komunën në të cilën lista është dorëzuar. Kodi Zgjedhor nuk përcakton asgjë për atë se a vlen ose jo kufizimi për shpenzimet për të dy rrethet e zgjdhjeve.

Neni 84 i Kodit Zgjedhor do të ketë dobi nga sqarime të mëtejshme për të përcaktuar se a vlejnë kufizimet për shpenzime në raste kur mbahen zgjedhje me dy rrethe.

Garuesit në zgjedhje kanë detyrë që të dorëzojnë dy raporte të përkohshme dhe një raport përfundimtar për shpenzimet e tyre tek KSHZ-ja, Enti Shtetëror për Revizion dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Këto raporte publikohen, ndihmojnë në ndërtimin e transparencës dhe i mundësojnë personat që të bëjnë një përzgjedhje të informuar përpara se ta japin votën e tyre. Edhe pse Ministria e Financave siguroi një formular për raportim, dhe i trajnoi partitë politike para zgjedhjeve për atë se si ta plotësojnë formularin, formularet e reja nuk kërkonin nga kandidatët që t'i ndajnë shpenzimet sipas detajeve. Pa këtë përvijim të detajuar nuk është e mundshme që raportet të shqyrtohen në tërësi.[38]

Rekomandohet që të përpilohen formulare më të detajuara për raportim lidhur me financimin e fushatës, të cilat do t'i detyrojnë kandidatët që shpenzimet t'i specifikojnë.

Raporti i parë për financimin e fushatës duheshte të dorëzohet më 14 mars dhe sipas KSHZ-së, 84 nga 121 raporte u dorëzuan në kohë. Raporti i dytë duheshte të dorëzohet më 23 mars dhe 56 nga 121 u dorëzuan në kohë. Nuk ka gjobë për mosdorëzimin e raporteve parazgjedhore. Sipas raporteve të dorëzuara financiare, VMRO-DPMNE-ja ka shpenzuar pesë here më shumë gjatë periudhës së fushatës se konkurruesi i saj më i afërt. Në pajtim me praktikat e mira, raportet përfundimtare për financimin e fushatës duhet të dorëzohen 30 ditë nga votimi, mirëpo ligji nuk është i qartë për atë se a i referohet kjo rrethit të parë të votimit apo të dytë.[39] Sipas ndryshimeve të fundit të ligjit, njëherit që raportet të dorëzohen, Enti Shtetëror për Revizion duhet t'i shqyrtojë ato brenda 60 ditëve dhe në rast të evidentimit të parregullësive të cilat janë në kundërshtim me dispozitat në Kodin Zgjedhor, të inicojë procedura për kundërvajtje.

Duhet të konsiderohet inicimi i sanksioneve proporcionale dhe zhbindëse për mosdorëzimin e raporteve parazgjedhore për financimin e fushatës. Ligji gjithashtu duhet me qartësi të përcaktojë kushtet për financimin e fushatës, në rastin e organizimit të një rrethi të dytë të zgjedhjeve.

Meqenëse dorëzuesit e listave janë të detyruar që të dorëzojnë një raport të unifikuar për të gjitha listat e tyre pa mos e ndarë atë sipas komunave, nuk është e mundshme që të përcaktohet se a janë respektuar kufizimet lidhur me shpenzimet.

---

38 Neni 7(3) i Konventës Kundër Korrupsionit të Kombeve të Bashkuara nga viti 2003 i detyron shtetet ta "përmirësojnë transparencën e financimit të kandidaturave për personat të cilët duan që të fitojnë poste publike."

39 Paragrafi 200 i OSBE/ODIHR-së dhe Udhëzimeve për Dispozitat mbi Partitë Politike të Komisionit të Venecisë thotë se "Raportet për financimin e fushatës duhet tu dorëzohen autoriteteve përkatëse në një periudhë jo më tepër se 30 ditë pas zgjedhjeve (…) Me qëllim që të përkrahet transparenca, është një praktikë e mirë që raportet e tilla financiare të publikohen në internet në kohë.

Rekomandohet që garuesit në zgjedhje të detyrohen që të sigurojnë përvijim të shpenzimeve sipas komunave, me qëllim që të vlerësohet se a janë respektuar rregullat për financimin e fushatës.

XI. MEDIAT

A. KLIMA MEDIATIKE

Numri i madh i mediave të regjistruara në vend janë të ndara në bazë gjuhësore dhe politike. Televizioni është burimi kryesor i informimit politik në vend. Në plotësim të tre kanaleve të transmetuesit publik, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM), 4 kanale komerciale transmetohen në nivel kombëtar, si dhe një numër i kanaleve rajonale dhe lokale. RTM-ja financohet nga një taksë për transmetim, e cila paguhet nga amvisëritë dhe personat juridik. Në vend, gjithashtu funksionojnë rreth 80 radio dhe 9 gazeta ditore, por edhe interneti përdoret shpesh si burim për informata politike.

Që nga zgjedhjet e fundit, mbyllja e dy transmetuesve dhe një numër të mediave të shtypit, shumë e ka zvogluar numrin e mediave të cilat janë kritike ndaj qeverisë. Në plotësim, qeveria është reklamuesi më i madh individual në vend, dhe disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-së e kuptonin shpërndarjen e reklamave qeveritare si shpërblim për politikat lojale editoriale.[40]

Këshilli për Radiodifuzion (KR) është i vetmi organ rregullues për mediat. Anëtarët e KR-së emërohen nga Kuvendi në bazë të propozimit të disa institucioneve jo të ndërlidhura me mediat. Ky proces shton shqetësimet lidhur me kapacitetin profesional të anëtarëve të KR-së për t'i zbatuar detyrat e tyre.

Duhet të konsiderohet përcaktimi i kushteve për emërimin e anëtarëve në Këshillin për Radiodifuzion, duke i dhënë përparësi profesionalizmit dhe paanshmërisë, dhe jo afërsisë politike.

B. KORNIZA LIGJORE

Mbulimi i fushatës zgjedhore nga ana e mediave rregullohet nga Kodi Zgjedhor, Ligji për Veprimtari Radiodifuzive, si dhe rregulloret e ndryshme të miratuara nga KR-ja. Më 12 nëntor të vitit 2012, si një veprim pozitiv u dekriminalizua shpifja.[41] Sipas kornizës ligjore, të gjithë transmetuesit duhet të sigurojnë mbulim të balancuar të të gjitha përmbajtjeve të ndërlidhura me zgjedhjet. Pas shpalljes së zgjedhjeve, mirëpo para fillimit zyrtar të fushatës, ndalohet çdo lloj lajmi i cili mund të duket se është në favor të cilës do partie politike ose kandidati. Me fillimin zyrtar të periudhës së fushatës, mediat elektronike janë të detyruara që të sigurojnë qasje të barabartë në media. Mirëpo, korniza ligjore nuk është e qartë sa i takon rregullimit të mbulimit mediatik në rrethin e dytë të zgjedhjeve.

Rekomandohet që në kornizën ligjore qartësisht të përvijohen dispozita për rrethin e dytë të fushatës në media.

RTM-ja nuk ka të drejtë të transmetojë reklama të paguara politike, por është e detyruar që të ndajë kohë për prezantime politike pa pagesë. Korniza ligjore nuk e adreson kohëzgjatjen e kohës së falur, e as atë se kur e njejta duhet të transmetohet. RTM-ja vendosi që çdo kandidati për kryetar komune t'i japë nga dy minuta, dhe nga një minut për çdo listë të kandidatëve për këshill komunal. Garuesit në zgjedhje

---

40 Sipas AGB Nielsen, në vitin 2012 organet e qeverisë kanë shpenzuar më tepër se 25 milion euro për tu reklamuar në media. Shih: http://www.agbnielsen.net/whereweare/dynPage.asp?lang=english&id=517&country=Macedonia.

41 Shih komunikatën për shtyp të OSBE Përfaqësuesit për Lirinë e Mediave, 14 nëntor 2012: http://www.osce.org/fom/97244.

shfaqën interes parcial për ta përdorur kohën falas, për shkak të kohës së shkurtër e cila u jepeshte dhe fakti se transmetimet bëheshin jashtë kohës me shikueshmëri më të madhe. RTM-ja vendosi që garuesve në rrethin e dytë mos tu japë kohë falas për reklamim, për shkak se korniza ligjore këtë nuk e kërkonte prej tyre, dhe në këtë mënyrë e kufizoi mundësinë e votuesve për të bërë një përzgjedhje të informuar.

Duhet të konsiderohet përcaktimi i kohëzgjatjes minimale për prezantime falas e cila u jepet garuesve në zgjedhje, dhe kërkesa që prezantimet falas të transmetohen gjatë kohës me shikueshmëri më të madhe.

Konsideratë duhet t'i jepet përcaktimit të kohës falas për transmetim për garuesit në zgjedhje gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve.

Ka mospërputhshmëri mes Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Veprimtari Radiodifuzive lidhur me sasinë e reklamave të paguara politike të lejuar në mediat private.[42] Sipas të dhënave të shpallura nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, shumica e kohës dhe hapsirës për reklamim të paguar politik është blerë nga VMRO-DPMNE-ja, dhe në një masë më të vogël nga BDI-ja.[43] Në shumicën e rasteve, VMRO-DPMNE ka fituar lëshime prej 20 përqind deri më 75 përqind nga çmimi fillestar për reklama të paguara, siqë është shënuar në çmimoren e publikuar përpara fillimit të fushatës. Lëshimet e tilla të çmimeve nuk ishën të shënuara në çmimoret dhe ishën të negociuara në vend nga ana e mediave, duke e anëshkaluar parimin e barazisë.

Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Veprimtari Radiodifuzive duhet të harmonizohen lidhur me sasinë e reklamimit të paguar e cila është e lejuar.

KR-ja ka detyrë që t'i mbikqyrë mediat elektronike gjatë periudhës së fushatës dhe të reagojë në rast të identifikimit të parregullësive. Përderisa monitorimi i mediave nga ana e KR-së mundësoi që në kohë të identifikohen parregullësitë, dështoi që të sigurojë zgjidhje në kohë dhe të mjaftueshme për parregullësitë e identifikuara. Monitorimi i mediave nga KR-ja identifikoi mungesë të mbulimit të balancuar gjatë rrethit të parë dhe të dytë të fushatës, në shumicën e mediave të monitoruara. Megjithatë, organi reagoi ndaj këtyre shkeljeve vetëm tre javë pas rrethit të dytë, duke inicuar masa kundërvajtëse për tetë media dhe kryeredaktorët e tyre. KR inicoi 41 procedura kundërvajtëse ndaj 26 mediave dhe kryeredaktorëve të tyre, për shkeljen e rregullave për reklamim të paguar politik dhe transmetimin e reklamave të paguara nga buxheti i shtetit. Në plotësim, monitorimi nga KR-ja evidentoi mungesë të balancit tek lajmet e shumicës së mediave elektronike kombëtare, të cilat favorizonin partitë qeveritare, si dhe shkeljen e rregullave për prezantimin e anketave nga *Siteli* dhe *radioja e RTM-së*. KR nuk ndërmorri asgjë lidhur me këto çështje përpara ditës së zgjedhjeve.

Duhet të përcaktohen afate kohore të qarta dhe të mjaftueshme që Këshilli për Radiodifuzion të reagojë në mënyrë efektive ndaj shkeljeve të mediave.

---

42 Kodi Zgjedhor e kufizon sasinë në 15 minuta për çdo orë, ndërsa Ligji për Veprimtari Radiodifuzive lejon maksimum 12 minuta në çdo orë.

43 Mediat ishën të detyruara që Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit t'i dorëzojnë raporte financiare për reklamimin e paguar politik. Raportet e dorëzuara janë të qasëshme në http://www.dksk.org.mk/.

C. VËZHGIMI I MEDIAVE NGA MVZ-JA E OSBE/ODIHR-SË

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së bëri monitorimin mediatik të mediave më të mëdha elektronike dhe të shtypit, gjatë të dy periudhave të fushatës.[44] Edhe pse të gjitha mediat e monitoruara siguruan një mbulim të gjërë të fushatës në lajmet e tyre, shumica e tyre shfaqën favorizim të madh të partive në pushtet, edhe në aspekt të kuantitetit, edhe në aspekt të përmbajtjes së raportimit. Në plotësim, të gjitha mediat e mbikëqyrura elektronike, përveç televizionit *Telma*, rregullisht i mbuluan aktivitetet qeveritare, por nuk arritën të bëjnë dallim ndërmjet aktiviteteve shtetërore dhe fushatës së partive. Ky model ishte edhe më i dukshëm gjatë rrethit të dytë të fushtës, kur mediat u fokusuan në aktivitetet qeveritare në komunat gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve.

Televizioni publik RTM-ja dështoi që të ofrojë mbulim të balancuar të fushatës. *RTM-1* 29 përqind të lajmeve ia kushtoi qeverisë në rrethin e parë (21 përqind në rrethin e dytë) dhe 27 përqind VMRO-DPMNE-së (37 përqind në rrethin e dytë), kryesisht me ton neutral ose pozitiv. LSDM-ja kishte mbulim ekskluzivisht neutral ose negativ prej 24 përqind në rrethin e parë (29 përqind në rrethin e dytë). *RTM-2*, me program në gjuhët e pakicave, kishte qasje të ngjashme, dhe 27 përqind të mbulimit kryesisht neutral në rrethin e parë (15 përqind në rrethin e dytë) ia kushtoi qeverisë, si dhe 21 përqind BDI-së qeverisëse (33 përqind në rrethin e dytë), ndërsa PDSH-ja fitoi 9 dhe 16 përqind të mbulimit kryesisht neutral në rrethin e parë dhe respektivisht në rrethin e dytë.

Në plotësim të lajmeve të tyre në rrethin e parë të fushatës *RTM-1* dhe *RTM-2* krijuan një program të posaçëm për zgjedhjet, *Kronika Zgjedhore*, për të siguruar transmetim më të detajuar të aktiviteteve të fushatës. Mirëpo ky program u transmetua jashtë kohës me shikueshmëri më të madhe, duke e kufizuar në një masë të madhe audiencën e saj. Përderisa më tepër se gjysma e emisionit *Kronika Zgjedhore* në *RTM-1* ishte e dedikuar për tubimet e VMRO-DPMNE-së, *RTM-2* ndau mes 17 dhe 20 pëqind të mbulimit të tillë për pesë garuesit më të mëdhenj (VMRO-DPMNE, LSDM, BDI, PDSH, RDK). *Kornika Zgjedhore* nuk u përgatit për rrethin e dytë të fushatës.

Përderisa *RTM-1* nuk organizoi asnjë debat, *RTM-2* organizoi 17 debate mes garuesve shqiptarë etnik gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve; shumica e tyre në favor të BDI-së. Një sërë përpjekjesh për të organizuar debate në mediat private dështuan, duke raportuar se kjo është kështu për shkak të mungesës së interesit nga ana e VMRO –DPMNE-së qeverisëse.

Sa u përket kanaleve private, *Sitel* dhe *Kanal 5* i favorizuan partitë në pushtet dhe kishin qëndrim kryesisht negativ ndaj opozitës, ndërsa *TV Telma*, *Alfa* dhe *Alsat-M*, ofruan mbulim më neutral. *Sitel*, televizioni më i famshëm privat në vend e favorizoi VMRO-DPMNE-në duke i kushtuar 49 përqind në rrethin e parë (42 përqind në rrethin e dytë) dhe atë transmetim kryesisht pozitiv, ndërsa LSDM-ja fitoi 21 përqind në rrethin e parë (32 përqind në rrethin e dytë) me ton kryesisht negativ. Tendenca të ngjajshme u vërejten edhe tek *Kanal 5*, i cili në rrethin e parë kushtoi 36 përqind (34 përqind në rrethin e dytë) transmetim kryesisht pozitiv dhe neutral për VMRO-DPMNE-në dhe 26 përqind në rrethin e parë (23 përqind në rrethin e dytë) të transmetimit kryesisht negativ dhe neutral për LSDM-në.

Edhe pse *Telma* u siguroi të gjithë garuesve kryesisht transmetim neutral, i kushtoi pak më shumë kohë

---

[44] Gjatë periudhës zyrtare të fushatës përpara rrethit të parë të zgjedhjeve (4 mars – 22 mars) MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së e vëzhgoi mbulimin politik në kohën me shikueshmëri më të madhe (18:00 deri më 24:00) në shtatë kanale televizive: publiket *RTM-1* dhe *RTM-2* dhe privatet *Alfa*, *Alsat-M*, *Kanal 5*, *Sitel*, dhe *Telma*; dhe pesë gazeta: *Dnevnik*, *Fokus*, *Koha*, *Nova Makedonia*, dhe *Zhurnal+*. Për rrethin e dytë (25 mars – 5 prill), MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së bëri vëzhgim të kufizuar të transmetimit politik gjatë kohës me shikueshmëri më të madhe *RTM-1* dhe *RTM-2*, si dhe lajmet gjatë kohës me shikueshmëri më të madhe të *Alsat-M*, *Kanal 5*, *Sitel*, dhe *Telma*.

LSDM-së. Gjatë lajmeve LSDM-ja fitoi 32 përqind në rrethin e parë (35 në rrethin e dytë), ndërsa VMRO-DPMNE-ja fitoi 25 përqind në rrethin e parë (28 përqind në rrethin e dytë). Në plotësim, *Alfa* siguroi transmetim kryesisht neutral dhe të balancuar të fushatës, edhe pse prej kohe në kohë favorizonte VMRO-DPMNE-në dhe Qeverinë.

Gjatë të dy rretheve zgjedhore, *Alsat-M* fokus më të madh kishte mbi partitë etnike shqiptare duke i kushtuar 24 përqind në rrethin e parë (26 përqind në rrethin e dytë) BDI-së, ndërsa 12 përqind në rrethin e parë (15 përqind në rrethin e dytë) i kushtoi PDSH-së. Në *Alsat-M*, VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja fituan transmetime proporcionalisht të ngjajshme edhe në rrethin e parë të fushatës, edhe në rrethin e dytë.

Krahasuar me mediat elektronike, mediat e shtypit shfaqën një spektër më të gjërë të pikëpamjeve. *Dnevnik* dhe *Nova Makedonija* në përgjithësi ofruan një pikturë të balancuar të fushatës, duke qenë më kritike ndaj LSDM-së dhe partive të tjera të opozitës. *Fokus* ishte shumë kritik ndaj Qeverisë dhe koalicionit qeverisës. Të dy gazetat në gjuhën shqipe, *Koha* dhe *Zhurnal+*, ishën kryesisht të fokusuara në aktivitetet e Qeverisë dhe BDI-së.

XII. VËZHGUESIT NDËRKOMBËTARË DHE TË QYTETARËVE

Kodi Zgjedhor mundëson që zgjedhjet të vëzhgohen nga vëzhgues ndërkombëtar dhe qytetarë, si dhe përfaqësues të autorizuar të kandidatëve në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Grupet vëzhguese të qytetarëve, të cilat e zbarkuan numrin më të madh të vëzhguesve ishën MOST, CIVIL dhe Instituti për Demokraci. Në pajtim me një rekomandim paraprak të OSBE/ODIHR-së, të gjithë vëzhguesit kishën të drejtë të marrin kopje të procesverbalit me rezultatet zgjedhore nga KZK-ja dhe të KZ-ja.

Në rrethin e parë, vëzhguesit e qytetarëve ishën prezent gjatë hapjes në 72 përqind të vendvotimeve të mbikqyrura nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së, gjatë procesit votues në 74 përqind të vendvotimeve, dhe gjatë procesit të numërimit në 80 përqind të vendvotimeve. Në plotësim, përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve ishën prezent në 96 përqind të vendvotimeve të vizituara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së.

XIII. ANKESAT DHE PARASHTESAT PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Mbrojtja e të drejtës zgjedhore garantohet në Kodin Zgjedhor, i cili mundëson bërjen e parashtesave tek organe të ndryshme administrative dhe juridike. KSHZ-ja ka jurisdiksion mbi ankesat lidhur me regjistrimin e votuesve, shkeljen e të drejtës së qytetarëve për të votuar në ditën e zgjedhjeve, dhe për votimin, numërimin dhe grumbullimin e rezultateve. Apelimet kundër vendimeve të tilla ndëgjohen nga Gjykata Administrative, vendimet e të cilës janë përfundimtare. Sipas Nenit 37(16) nga Kodi Zgjedhor, KZK-të gjithashtu kanë autoritet për të vendosur lidhur me ankesat, mirëpo jurisdiksioni i saktë i KSHZ-së dhe KZK-ve lidhur me ankesat është i paqartë. Si rezultat, KZK-të ia transmetuan për shqyrtim KSHZ-së të gjitha ankesat lidhur me zgjedhjet.

Jurisdiksioni lidhur me ankesat para ditës zgjedhore do të ketë dobi nga një përshkrim të detajuar për kompetencat e KSHZ-së dhe KZK-ve.

Afatet kohore për sjelljen e vendimeve për konfliktet e ndërlidhura me zgjedhjet janë të shkurtëra. Në kundërshtim me rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit të Venecisë, korniza kohore për sjelljen e vendimeve lidhur me ankesat për dorëzimin e listave të kandidatëve është shkurtuar

për 24 orë, duke i shtuar kërkesat nga gjykatësit që të sjellin vendim mbi ankesat, në veçanti kur gjykata duhet të vendosë për ankesa të shumta përnjëherë. Sidoqoftë, Gjykata Administrative i respektoi afatet kohore gjatë këtyre zgjedhjeve.

Duhet të konsiderohet zgjerimi i afatit kohor për sjelljen e vendimeve lidhur me ankesat nga ana e gjykatave, duke siguruar që i njejti të jetë mjaft i shkurtër për të siguruar një zgjidhje efektive.

Pavarësisht nga rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR-së, KSHZ-ja ende nuk ka miratuar një procedurë të detajuar për parashtrimin dhe zgjidhjen e ankesave. Mungesa e procedurave të qarta për trajtimin e ankesave përpara ditës zgjedhore nga ana e KSHZ-së ndikon mbi korrigjimin efektiv, siqë është paraparë në paragrafin 5.10 të OSBE Dokumentit të Kopenhagës nga viti 1990.[45] Numri i ankesave të dorëzuara dhe mungesa e resurseve për t'i shqyrtuar ankesat do të thotë se shumë ankesa kaluan pa mos u adresuar, dhe kjo rezultoi në një zbatim jokonzistent të Kodit Zgjedhor.

Legjislacioni zgjedhor duhet të sigurojë një proces të qartë dhe të detajuar për garuesit në zgjedhje dhe votuesit për të paraqitur ankesa dhe parashtesa, të cilat burojnë nga shkeljet e pretenduara të Kodit Zgjedhor dhe dispozitat e miratuara nga KSHZ-ja. Gjithashtu, mund të konsiderohet krijimi i një Departamenti Juridik në kuadër të KSHZ-së, i cili do t'i informojë anëtarët e KSHZ-së për gjendjen ligjore dhe skicë dokumentet ligjore, si dhe për justifikimet.

Njëmbëdhjetë ankesa u dorëzuan në Gjykatën Administrative gjatë periudhës së regjistrimit të kandidatëve, të cilat e kontestonin rrefuzimin e listave të kandidatëve nga ana e KZK-ve, nga të cilat katër u miratuan. Me zgjerimin e afatit për regjistrimin e kandidatëve, tre lista të kandidatëve të cilat inicialisht u rrefuzuan nga KZK-të për shkak të dorëzimit të vonshëm u ridorëzuan dhe u pranuan.

Për shkak të mungesës së procedurave të qarta dhe afateve për trajtimin e ankesave përpara ditës së zgjedhjeve, KSHZ-ja nuk solli vendim për 431 ankesa të dorëzuara përpara ditës zgjedhore në rrethin e parë lidhur me pretendimet për fushatë të hershme.

Për tu garantuar korrigjimi efektiv, duhet të konsiderohet përcaktimi i afateve për KSHZ-në për hetimin e ankesave lidhur me bërjen e fushatës së hershme.

Ankesat të cilat pretendojnë kundërvajtje zgjidhen nga gjykatat themelore, me mundësi për apelim në Gjykatën e Apelit. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së u informua se asnjë ankesë nuk është paraqitur tek gjykatat themelore gjatë fushatës zgjedhore. Përfaqësues të disa partive politike i treguan MVZ-së të OSBE/ODIHR-së se ato kanë mungesë besimi në procedurat për ankim dhe aftësinë e këtyre gjykatave për t'i zgjidhur ato në mënyrë neutrale.

Shtatëdhjetë e tre parashtesa janë dorëzuar nga LSDM-ja në KSHPK për keqpërdorimin e resurseve shtetërore nga VMRO-DMPNE gjatë fushatës zgjedhore. Këto parashtesa nuk u trajtuan para përfundimit të periudhës zgjedhore.[46] Më 3 prill, KSHPK shpalli inicimin e një procedure kundërvajtëse ex officio kundër Andrej Zhernovskit, kandidat i opozitës në komunën Qendër (Shkup), për parregullësi të pretenduara në raportet financiare gjatë kohës kur ai ka qenë deputet në Kuvend mes 2002 dhe 2011.

---

[45] Paragrafi 5.10 i OSBE Dokumentit të Kopenhagës nga viti 1990 përcakton se "secili do të ketë mjete efektive për zgjidhje kundër vendimeve administrative, që të garantohet respektimi i të drejtave fundamentale dhe të sigurohet integritet legal."

[46] Komisioni ia bëri me dije MVZ-së të OSBE/ODIHR-së se ato kanë mungesë të resurseve të nevojshme për t'i hetuar jo vetëm rastet gjatë fushtës zgjedhore, por edhe kërkesat për mendim ose raste të tjera nën jurisdiksionin e tyre.

Z. Zhernovski pohonte se momenti i shpalljes së këtij veprimi ishte politikisht i motivuar.

Mund të konsiderohet krijimi i afateve për Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për t'i hetuar ankesat lidhur me keqpërdorimin e resurseve shtetërore gjatë fushatës, dhe duhet të sigurohen resurset e nevojshme për t'i zgjidhur ato për një kohë të arsyeshme.

XIV. DITËT ZGJEDHORE

A. VOTIMI NË RRETHIN E PARË

Votimi i hershëm u mbajt më 23 mars për votuesit të cilët votojnë në shtëpi, të burgosurit dhe personat e zhvendosur brenda vendit.[47] Vlerësimi i përgjithshëm i MVZ-së së OSBE/ODIHR-së ishte pozitiv në 61 nga 72 raste të vëzhguara. Megjithatë, në 14 raste gjatë votimit në shtëpi nuk u respektua fshehtësia e votës, ndërsa njohja e procedurave nga ana e votuesve u vlerësua negativisht në 4 raste. Vëzhguesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-së gjithashtu vërejtën se disa të burgosur nuk ishën të përfshirë në listat e votuesve.

Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe paqësore, ndonëse u vërejtën disa parregullësi teknike. Në ditën e zgjedhjeve MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së vëzhgoi hapjen dhe votimin në 828 vendvotime dhe numërimin në 82 vendvotimeve, si dhe grumbullimin e rezultateve në 88 nga 81 KZK.

Vëzhguesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-së e vlerësuan hapjen e vendvotimeve pozitivisht në 99 përqind të vëzhgimeve. Shtatëmbëdhjetë nga vendvotimet e vizituara u hapën me vonesa të shkurtëra, por kjo nuk i pengoi votuesit që të votojnë. Në 14 vëzhgime, seksionet fillestare të protokolit nuk u plotësuan përpara hapjes, siqë edhe kërkohet nga Kodi Zgjedhor. Parregullësi të tjera u vërejtën në një numër të vogël të rasteve, duke përfshirë edhe moskontrollimin e materialeve zgjedhore përpara hapjes nga ana e KZ-ve në katër vëzhgime, mosverifikimin e të qenurit e zbrazët të kutisë votuese nga ana e KZ-ve në pesë raste, dhe mbyllja joadekuate e kutive votuese nga KZ-ve në tre raste.

Vlerësimi i përgjithshëm i procesit votues ishte i mirë ose shumë i mirë në 94 përqind të monitorimeve. Vëzhguesit nuk u penguan dhe mundeshin qartësisht t'i vëzhgojnë procedurat në 98 përqind të rasteve. Megjithatë, parregullësi procedural u vërejtën në një numër të vendvotimeve të vizituara. Kjo përfshinte votimin grupor në 15 përqind të vendvotimeve të vëzhguara, mosrespektimin e fshehtësisë së votës në 12 përqind të rasteve, votimi në emër të tjetërkujt në 3.5 përqind të rasteve, dhe mbyllja jo adekuate e kutive votuese në 3 përqind të rasteve. Në 11 përqind të vendvotimeve të vëzhguara, votuesit u rrefuzuan për shkak se emrat e tyre nuk ishën në listen e votuesve në atë vendvotim të posaçëm. Performanca e KZ-ve dhe njohja e procedurave të votimit nga ana e tyre u vlerësuara pozitivisht në 90 përqind të rasteve. Disa parti i shprehën shqetësimet e tyre për numrin e madh të diasporës e cila u kthye në vend për të votuar në ditën e zgjedhjeve.

Në plotësim, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së vërejti se fshehtësia e votës mund të rrezikoheshte në 60 vendvotimet me më pak se 10 votues të regjistruar.

---

[47] Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për të votuar në shtëpi ishte një përqind nga numri i përgjithshëm i atyre që kanë votuar.

Për ta siguruar fshehtësinë e votës, autoritetet mund të konsiderojnë që numërimin e votave nga vendvotimet e vogla ta bëjnë në nivel komunal ose përmes mënyrave të tjera, duke e ruajtur integritetin e procesit zgjedhor.

Numërimi i votave u vlerësua pozitivisht në 66 nga 81 numërime të vëzhguara, dhe vëzhguesit kishën pamje të plotë në procedurat e numërimit në 97 përqind të rasteve. Megjithatë, procedura për numërimin e votave nuk ishte mirë e organizuar në 24 raste të vëzhguara, dhe gabime procedural u vërejtën në 18 raste të numërimeve. Përderisa transparenca e numërimit u vlerësua pozitivisht në 92 përqind të rasteve, protokoli i rezultateve nuk u vendos publikisht në 44 përqind të vendvotimeve të vëzhguara, siqë edhe kërkohet nga Kodi Zgjedhor.

B. VOTIMI NË RRETHIN E DYTË

Votimi i hershëm u mbajt më 6 prill për votuesit të cilët votojnë në shtëpi, të burgosurit dhe personat e zhvendosur brenda vendit. Si edhe në rrethin e parë, fshehtësia e votës për votuesit të cilët votojnë në shtëpi vazhdoi të jetë problematike, dhe instancat e mospërfshirjes së të burgosurve në listat e votuesve përsëri u vërejtën.

Si edhe në rrethin e parë, votimi në shumicën e vendvotimeve të vizituara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së ishte i qetë dhe i organizuar, dhe procedurat në shumicë u respektuan. Anëtarët e KZ-ve në vendvotimet e vizituara e menaxhuan procesin efektivisht. U vërejtën instanca të votimit në grupe. Edhe pse disa vendvotime e anuluan votimin për një periudhë të shkurtër për të zgjidhur disa çështje teknike ose ankesa, e njejta nuk ndikoi negativisht në procesin e votimit.

Si edhe në rrethin e parë, disa bashkëbisedues të OSBE/ODIHR-së i shprehën brengat e tyre për numrin e madh të diasporës e cila kthehesh te vend me qëllim që të votojë në ditën e zgjedhjeve. Në veçanti, disa parti e vënë në pyetje legjitimitetin e lejimit që të regjistrohen dhe votojnë maqedonasit etnik të cilët banojnë në Shqipëri. Ky ishte një shqetësim i posaçëm në Komunën e Qendrës në Shkup, ku u raportua se një numër i madh i njerëzve janë regjistruar në listat e votuesve, edhe pse nuk ishën banor të Qendrës.

Në një numër të kufizuar të vendvotimeve të vëzhguara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së, numërimi i votave u bë në një mënyrë profesionale dhe transparente, me vetëm disa probleme procedurale të vërejtura.

C. NUMËRIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

Gjatë të dy rretheve, procesi i grumbullimit të votave u zhvillua në mënyrë profesionale, edhe përpos të disa problemeve teknike të hasura në rrethin e parë. Vëzhguesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-së e vlerësuan procesin e numërimit dhe grumbullimit të votave si të mirë ose shumë të mirë në 93 përqind të rasteve të KZK-ve të vëzhguara në rrethin e parë, ku vëzhguesit në përgjithësi kishën mundësi që të vëzhgojnë pa asnjë pengesë. Disa diskrepanca u vërejtën në protokolet e rezultateve të KZ-ve në 18 raste, mirëpo këto në shumicë u korrigjuan nga KZK-të. Në rrethin e dytë të votimit, procesi i numërimit dhe grumbullimit të votave u administrua mirë në ato disa KZK të vizituara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së.

Rezultatet paraprake të rrethit të parë të zgjedhjeve lokale u shpallën në ueb faqen e KSHZ-së ashtu siqë pranoheshin nga KZK-të, me ndarje të votave sipas komunave dhe vendvotimeve. Procesi ishte

transparent dhe shumica e rezultateve të KZK-ve u shpallën në ueb faqen në mëngjesin pas zgjedhjeve. Megjithatë, 41 komuna dështuan që t'i përmbahen afatit të shkurtër kohor për t'i shpallur rezultatet paraprake dhe rezultatet e 15 KZK ende nuk ishën të vendosura në ueb faqen e KSHZ-së deri në mëngjesin e 26 marsit. Pas intervenimit të KSHZ-së dhe thirrjes për verifikim në KZK-të të cilat ishën me vonesë, rezultatet paraprake u shpallën të martën, 26 mars më 20:00 ora. Pas përfundimit të procesit të ankesave, KSHZ-ja i shpalli rezultatet finale të rrethit të parë më 2 prill.

Gjatë rrethit të dytë të votimit, të gjitha KZK-të arritën që KSHZ-së t'ia dorëzojnë rezultatet në kohë, të cilat pastaj u publikuan në ueb faqen e KSHZ-së të ndara sipas komunave dhe vendvotimeve. Afati aktual për shpalljen e rezultateve u kritikua nga KSHZ-ja dhe bashkëbiseduesve të tjerë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-së për të qenë tepër i shkurtër.[48]

Në rrethin e parë të zgjedhjeve u zgjodhen dyzet e nëntë kryetar komunash, me shumicën e votave të nevojshme. Garat në rethin e dytë mes dy kandidatëve me numrin më të madh të votave u organizuan më 7 prill, në 29 komuna dhe Qytetin e Shkupit. Më 7 prill, votimi duheshte të përsëritet për rrethin e parë në disa vendvotime në Dollnen dhe Strumicë.

XV. ANKESAT DHE PARASHTESAT PASZGJEDHORE

A. ANKESAT DHE PARASHTESAT PËR DITËN E ZGJEDHJEVE NË RRETHIN E PARË

Pas rrethit të parë të zgjedhjeve, 8 parti politike dhe koalicione dorëzuan gjithsej 402 ankesa në KSHZ, duke i sfiduar rezultatet në 476 vendvotime. KSHZ-ja solli 173 vendime, duke pranuar 6 nga ankesat.[49] Shumica e ankesave u rrefuzuan në baza procedurale. Për shembull, edhe pse Kodi Zgjedhor nuk kërkon në mënyrë të përpiktë që një shkelje në ditën zgjedhore të shënohet në protokolin e KZ ose KZK që KSH-ja ta shqyrtojë ankesën, në disa raste ankesat u rrefuzuan për këtë shkak. Të tjera u rrefuzuan për shkak se në vendvotimin e njejtë nuk janë dorëzuar dy ankesa siqë kërkohet nga Kodi Zgjedhor.

Neni 31(2)(35) i Kodit Zgjedhor i cili i jep mandat KSHZ-së që ta kontrollojë materialin zgjedhor lidhur me ndonjë ankesë vetëm në rast kur për vendvotimin në fjalë janë dorëzuar dy ankesa, duhet të hiqet për shkak se e dëmton të drejtën në zgjidhje efektive. Nuk duhet të ketë prag për numrin e ankesave të dorëzuara përpara se ato të shqyrtohen.

KSHZ-ja vendimet për ankesat në rrethin e parë të zgjedhjeve parimisht i solli sipas interesave politike, dhe jo bazës ligjore të ankesës, ku anëtarët votonin sipas bindjeve të tyre politike. Anëtarët e KSHZ-së gjithashtu rregullisht dhe pa konzistencë votuan kundër shqyrtimit të materialit zgjedhor, përpara se të vendosin për cilësitë e një ankese. Kjo rezultoi në sjelljen e vendimeve jo konzistente dhe kontradiktore për ankesat e bëra për parregullësitë e njejta.

Në bazë të ankesave të pranuara, KSHZ-ja i anuloi rezultatet në tre vendvotime në Strumicë për shkak të parregullësive në bazë të ankesave të bëra nga VMRO-DPMNE-ja, si dhe në një vendvotim në Dollnen në bazë të ankesës së PDSH-së. Në komunën e Çairit, KSHZ-ja votoi që të shqyrtohet materiali zgjedhor në 13 vendvotime në bazë të ankesës së PDSH-së, e cila pohonte se rezultatet në protokolin e KZK-së

---

48 Sipas Nenit 135 të KZ, KZK-të kanë 7 orë nga mbyllja e vendvotimeve për t'i shpallur rezultatet në komunën e tyre, ndërsa Komisioni Zgjedhor për Qytetin e Shkupit ka 10 orë për t'i shpallur rezultatet.

49 Tre ankesa nga VMRO–DPMNE-ja për Strumicën, dy nga PDSH-ja për Çairin dhe Dollnenin, dhe një nga LSDM-ja për Ohrin.

nuk përputheshin me ato në protokolet e KZ-ve. KSHZ-ja e pranoi ankesën dhe i ndryshoi rezultatet e 13 vendvotimeve. Gjë e cila rezultoi në organizimin e rrethit të dytë në Çair. Në plotësim, KSHZ-ja e shkarkoi KZK-në dhe anëtarët e 13 KZ-ve.

Rezultatet në shumë vendvotime u anuluan nga KSHZ-ja në bazë të Nenit 151 (1) të Kodit Zgjedhor, i cili e bën të detyrueshme anulimin e rezultateve në një vendvotim të caktuar në rastet e parregullësive të vogla. Kjo mund të shkaktojë shkeljen e tërërsishme të të drejtës së votuesve në një vendvotim të tërë, pa mos bërë analizë për atë se a kanë ose jo efekt parregullësitë mbi rezultatet.

Rekomandohet që Neni 151(1) i Kodit Zgjedhor të ndryshohet me qëllim që të mundësohet që rezultatet zgjedhore të anulohen vetëm në rast të shkeljeve të rënda, të cilat ndikojnë mbi rezultatin e përgjithshëm zgjedhor.

Gjykata Administrative gjykoi për 142 ankesa kundër vendimeve të KSHZ-së, nga të cilat 141 u rrefuzuan si të papabaza. U pranua një apelim i VMRO-DPMNE për një vendvotim në Kërçovë, mirëpo nuk u urdhërua organizimi i rrethit të dytë të votimit për shkak se rezultati final nuk do të ndryshonte. Gjykimet publike të Gjykatës Administrative, siqë u vëzhguan nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së, ishën formalistike dhe nuk dhanë mundësi që ankuesit të dorëzojnë dëshmi.[50] Vendimet e gjykatës në shumicën e rasteve bazoheshin mbi ankesën me shkrim, vendimin e KSHZ-së dhe protokolet e vendvotimeve. Kjo pjesërisht ishte rezultat i numrit të madh të ankesave të dorëzuara dhe afatet e shkurtëra kohore që Gjykata të sjellë vendim. Edhe pse Gjykata Administrative i përmbushi afatet ligjore, kapaciteti i tyre për t'i hetuar dhe përgatitur në mënyrë adekuate rastet në kuadër të afateve të caktuara kohore mbetet i pasigurtë.

B. ANKESAT DHE PARASHTESAT NË RRETHIN E DYTË

Partitë politike dhe koalicionet dorëzuan 387 ankesa në KSHZ lidhur me procedurat e votimit në rrethin e dytë të zgjedhjeve. KSHZ-ja solli vendime për sfidat në 369 vendvotime, nga të cilat 2 u pranuan dhe 1 u pranua pjesërisht.[51]

Shumica e ankesave u rrefuzuan në bazat e njejta si edhe ato të cilat u dorëzuan në rrethin e parë. Në tre raste. KSHZ-ja vendosi t'i hapë kutitë votuese dhe ta shqyrtojë materialin zgjedhor, si edhe në rrethin e parë, afatet për sjelljen e vendimeve nuk ishën në tërësi të respektuara dhe KSHZ-ja nuk ishte konzistente në sjelljen e vendimeve për ankesat e natyrës së njejtë.

Gjykata Administrative gjykoi për 136 parashtesa lidhur me vendimet e KSHZ-së. Gjykata rrefuzoi 95 dhe pranoi 41 parashtesa, 36 të dorëzuara nga VMRO-DPMNE lidhur me vendvotime në Strugë dhe Qendër, dhe pesë të dorëzuara nga LSDM-ja lidhur me 4 vendvotime në Qytetin e Shkupit dhe 1 vendvotim në Gjorçe Petrov. Në disa instanca Gjykata Administrative solli vendime kundërthënëse, duke i anuluar rezultatet në disa vendvotime ku u zbulua se në kutinë votuese ka një fletëvotimi më tepër se numri i njerëzve të cilët në fakt kanë votuar, dhe në raste të tjera duke sjellë vendim se kjo gjë nuk është e mjaftueshme për t'i anuluar rezultatet. Më 14 prill, kryetari i Gjykatës Administrative dha dorëheqje pas publikimit të vendimeve për Strugën dhe komunën e Qendrës, duke pohuar se ai ka dhënë dorëheqje për arsye morale për shkak të ndarjeve etnike në mes gjykatësve të Gjykatës.

---

[50] Duhet të theksohet se në bazë të dijenisë së MVZ-së të OSBE/ODIHR-së, asnjëra nga ankesat nuk kërkonte mundësinë që të ndëgjohet gjatë gjykimeve.

[51] Dy ankesat e VMRO-DPMNE-së për vendvotimet 1860 dhe 1877 në Strugë u pranuan, edhe pse këto anulime nuk ndikuan mbi rezultatin final. Parashtesa e VMRO-DPMNE për vendvotimin 1020 në Kumanovë u pranua pjesërisht.

Pas vendimeve të Gjykatës Administrative, rreth i dytë i përsëritur i zgjedhjeve u organizua në 29 vendvotime në Qendër, në 9 vendvotime në Strugë dhe 1 vendvotim në Gjorçe Petrov më 21 prill. Votim i rrethit të dytë u mbajt në të gjitha 39 vendvotimet në Dollnen. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së nuk i vëzhgoi votimet e mbajtura më 21 prill. KSHZ-ja i shpalli rezultatet finale më 23 prill.

XVI. REKOMANDIME

Rekomandimet e ardhshme, siqë janë të përvijuara përgjatë gjithë tekstit, ofrohen për konsiderim nga autoritetet, partitë politike dhe shoqërisë civile, me qëllim që të përkrahen përpjekjet për zbatimin e zgjedhjeve të cilat do të jenë në përputhshmëri me zotimet e OSBE-së, dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhet të ndërlidhen me rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR-së, të cilat kanë mbetur pa mos u adresuar. OSBE/ODIHR-ja është e gatshme që t'i ndihmojë autoritetet e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në përmirësimin e mëtutjeshëm të procesit zgjedhor dhe në përmbushjen e rekomandimeve të cilat janë të përmbajtura në këtë raport.

A. REKOMANDIME PRIORITARE

1. Reformat e Kodit Zgjedhor duhet t'i trajtojnë rekomandimet e identifikuara në këtë raport, si dhe raportet paraprake të OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit të Venecisë. Rekomandohet që Kodit Zgjedhor t'i shtohen dispozita të qarta për rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale. Reformat duhet të jnë gjithëpërfshirëse dhe të kompletuara shumë përpara zgjedhjeve të ardhshme.

2. Duhet të konsiderohet zbatimi i një shqyrtimi të procedurave për përpilimin dhe mirëmbajtjen e listave të votuesve. Procedura të qarta, të koordinuara dhe transparente do ta përmirësojnë saktësinë e listave të votuesve dhe do të kontribuojnë në besimin e publikut.

3. Legjislacioni zgjedhor duhet të sigurojë një proces të qartë dhe të detajuar për garuesit në zgjedhje dhe votuesit për të paraqitur ankesa dhe parashtesa, të cilat burojnë nga shkeljet e pretenduara të Kodit Zgjedhor dhe dispozitat e miratuara nga KSHZ-ja. Gjithashtu mund të konsiderohet krijimi i një Departamenti Juridik në kuadër të KSHZ-së, i cili do t'i informojë anëtarët e KSHZ-së për gjendjen ligjore dhe skicë dokumentet ligjore, si dhe për justifikimet.

4. Me qëllim që më tej të përforcohet besimi publik në procesin zgjedhor, dhe të sigurohet një mjedis i hapur për të bërë fushatë, autoritetet relevante duhet të ndërmarrin iniciativa më të mëdha për hetimin adekuat të akuzave për frikësimin e votuesve dhe të ndërmarrin veprime adekuate në rast të dështimit të shkeljes së të njejtës.

5. Rekomandohet që Neni 151(1) i Kodit Zgjedhor të ndryshohet me qëllim që të mundësohet që rezultatet zgjedhore të anulohen vetëm në rast të shkeljeve të rënda të cilat ndikojnë mbi rezultatin e përgjithshëm zgjedhor.

B. REKOMANDIME TË TJERA

Korniza Ligjore

6. Kodi Zgjedhor duhet të përcaktojë se çfarë ndodh me zgjedhjet lokale atëherë kur në rrethin e parë numri i votuesve të cilët kanë votuar, është më i vogël se një e treta e votuesve të regjistruar.

Administrata Zgjedhore

7. KSHZ-ja duhet më tej ta avancojë transparencën e saj, duke e respektuar rreptësisht kërkesën për publikimin e të gjitha procesverbaleve të takimeve në ueb faqen e saj. Kodi Zgjedhor mund të plotësohet për të përcaktuar se procesverbalet duhet të publikohen jo më vonë se 48 orë pasiqë të mbahet seanca.

8. KSHZ-ja duhet t'i zgjedhë të gjitha ankesat dhe parashtesat në mënyrë të paanshme, pa peshën e konsideratave të motivuara në mënyrë politike. Ligji duhet të interpretohet, zbatohet dhe përforcohet sipas qëllimeve të vetë ligjit.

9. KSHZ-ja duhet të sigurojë më tepër informata dhe edukim për votuesit, në veçanti sa i takon kohës dhe procedurave për freskimin e të dhënave personale në listën e votuesve, dhe për fshehtësinë e votës.

10. Rekomandohet që KZK-ve tu sigurohen resurset e nevojshme në kohë. Në plotësim, transparenca e punës do të zmadhohet nëse KZK mbajnë vetëm seanca publike, të cilat do të paralajmërohen përpara kohe.

11. Duhet të konsiderohet organizimi frekuent dhe më i detajuar i trajnimeve për anëtarët e KZ-ve.

12. Për ta siguruar fshehtësinë e votës, autoritetet mund të konsiderojnë që numërimin e votave nga vendvotimet e vogla ta bëjnë në nivel komunal ose përmes mënyrave të tjera, duke e ruajtur integritetin e procesit zgjedhor.

Regjistrimi i votuesve

13. Duhet të konsiderohet një ndryshim i afatit kohor për finalizimin e listave të votuesve me qëllim që i njejti të jetë më afër ditës së zgjedhjeve.

Regjistrimi i kandidatëve

14. Kodi Zgjedhor mund të përfshijë dispozita specifike lidhur me kohën dhe kushtet për tërhekjen e listave të regjistruara të kandidatëve. Mund të shqyrtohet edhe krijimi i mundësisë që një listë e kandidatëve të miratohet pjesërisht (për shembull, të pranohen vetëm emrat e kandidatëve në listë të cilët i përmbushin kriteret ligjore dhe të tjerët të fshihen nga lista). Nëse dispozitat inicohen, rekomandohet që të krijohen mekanizma mbrojtëse që të mos keqpërdoret e drejta për tërhekjen e listave të kandidatëve.

15. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për rritjen e numrit të kandidatëve femra. Duhet të

konsiderohet ndryshimi i Nenit 64.5 nga Kodi Zgjedhor, ku i njejtë do të përcaktojë se në rast se një femër e zgjedhur nga një listë e kandidatëve për këshillin komunal jep dorëheqje, e njejta do të zëvendësohet nga femra e ardhshme në listë.

Fushata Zgjedhore

16. Autoritetet duhet të shfaqin vullnet më të madh politik për të mundësuar dallim të mjaftueshëm mes shtetit dhe partisë. Garancionet ekzistuese ligjore, siqë është Neni 8-a dhe 9 nga Kodi Zgjedhor, duhet të interpretohen në një mënyrë konzistente me qëllim që të parandalohet konflikt interesash mes pozitave të pushtetit ekzekutiv të cilat kërkojnë neutralitet, dhe kandidatëve të cilët aspirojnë avantazh politik. Dispozitat duhet më tej të plotësohen për të përfshirë mekanizma për detyrim.

Financimi i Fushatës

17. Siqë është rekomanduar paraprakisht, dallimi në natyrën e limiteve mes individëve dhe personave juridik duhet të rishqyrtohet. Dispozitat aktuale janë diskriminuese dhe u japin avantazh të padrejtë entiteteve të mëdha.

18. Neni 84 i Kodit Zgjedhor do të ketë dobi nga sqarime të mëtejshme për të specifikuar se a vlejnë kufizimet për shpenzime në raste kur mbahen zgjedhje me dy rrethe**.**

19. Rekomandohet që të përpilohen formulare më të detajuara për raportim lidhur me financimin e fushatës të cilat do t'i detyrojnë kandidatët që shpenzimet t'i specifikojnë.

20. Duhet të konsiderohet inicimi i sanksioneve proporcionale dhe zhbindëse për mosdorëzimin e raporteve parazgjedhore për financimin e fushatës. Ligji gjithashtu duhet me qartësi të përcaktojë kushtet për financimin e fushatës, në rastin e organizimit të një rrethi të dytë të zgjedhjeve.

21. Rekomandohet që garuesit në zgjedhje të detyrohen që të sigurojnë përvijim të shpenzimeve sipas komunave, me qëllim që të vlerësohet se a janë respektuar rregullat për financimin e fushatës.

Mediat

22. Duhet të konsiderohet përcaktimi i kushteve për emërimin e anëtarëve në Këshillin për Radiodifuzion, duke i dhënë përparësi profesionalizmit dhe paanshmërisë, dhe jo afërsisë politike.

23. Konsideratë duhet t'i jepet alokimit të kohës falas për transmetim për garuesit në zgjedhje gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve.

24. Rekomandohet që në kornizën ligjore qartësisht të përvijohen dispozita për rrethin e dytë të fushatës në media.

25. Duhet të konsiderohet përcaktimi i kohëzgjatjes minimale për prezantime falas e cila u jepet garuesve në zgjedhje, dhe kërkesa që prezantimet falas të transmetohen gjatë kohës me

shikueshmëri më të madhe.

26. Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Veprimtari Radiodifuzive duhet të harmonizohen lidhur me sasinë e reklamimit të paguar e cila është e lejuar.

27. Duhet të përcaktohen afate kohore të qarta dhe të mjaftueshme që Këshilli për Radiodifuzion të reagojë në mënyrë efektive ndaj shkeljeve të mediave.

Ankesat dhe Parashtesat

28. Jurisdiksioni lidhur me ankesat para ditës zgjedhore do të ketë dobi nga një përshkrim i detajuar për kompetencat e KSHZ-së dhe KZK-ve.

29. Duhet të konsiderohet zgjerimi i afatit kohor për sjelljen e vendimeve lidhur me ankesat nga ana e gjykatave, duke siguruar që i njejti të jetë mjaft i shkurtër për të siguruar një zgjidhje efektive.

30. Për tu garantuar korrigjimi efektiv, duhet të konsiderohet përcaktimi i afateve për KSHZ-në për hetimin e ankesave lidhur me bërjen e fushatës së hershme.

31. Mund të konsiderohet krijimi i afateve për Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për t'i hetuar ankesat lidhur me keqpërdorimin e resurseve shtetërore gjatë fushatës, dhe duhet të sigurohen resurset e nevojshme për t'i zgjidhur ato për një kohë të arsyeshme.

32. Neni 31(2) (35) i Kodit Zgjedhor i cili i jep mandat KSHZ-së që ta kontrollojë materialin zgjedhor lidhur me ndonjë ankesë vetëm në rast kur për vendvotimin në fjalë janë dorëzuar dy ankesa, duhet të hiqet për shkak se e dëmton të drejtën në zgjidhje efektive. Nuk duhet të ketë prag për numrin e ankesave të dorëzuara që ato të shqyrtohen.

XVII. REZULTATET PËRFUNDIMTARE[52]

Rezultatet për kryetar komune	**Rrethi 1**		**Rethi 2[53]**		**Përsëritje[54]**	
Numri i përgjithshëm i votuesve	1,743,403		931,554		145,629	
Pjesëmarrja e votuesve	1,164,687	66.81%	551,744	59.23%	94,471	64.87%
Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme	1,124,398	96.54%	534,486	96.87%	92,783	98.21%
Numri i përgjithshëm i votave të pavlefshme	40,289	3.46%	17,258	3.12%	1,688	1.78%
	Vende		**Vende**		**Vende**	
Organizata e Brendshme Revolcionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)	38		15		2	
Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM)	2		1		1	
Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)	7		7		0	
Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)	0		1		1	
Kandidat i pavarur	1		1		0	
Partia Progresive Serbe (SPP)	0		1		0	
Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë (DPTM)	1		0		0	
Lidhja e Romëve të Maqedonisë (URM)	1		0		0	

Rezultatet zgjedhore për kryetar komune në Qytetin e Shkupit	**Rrethi 1**		**Rethi 2**	
Numri i përgjithshëm i votuesve	444,259		444,259	
Pjesëmarrja e votuesve	284,119	63.95%	209,696	47,20%
Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme	270,808	95.31%	200,845	95.78%
Numri i përgjithshëm i votave të pavlefshme	13,311	4.69%	8,851	4.22%
	Vende			
VMRO-DPMNE	0		1	

Rezultatet zgjedhore për këshillin komunal		**%**	
Numri i përgjithshëm i votuesve	1,743,403		
Pjesëmarrja e votuesve	1,167,768	66.98%	
Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme	1,117,814	95.72%	
Numri i përgjithshëm i votave të pavlefshme	49,954	4.28%	
Partia	**Vota**	**%**	**Vende**
VMRO-DPMNE	416,972	37.30%	537
Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM)	328,547	29.39%	381
Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)	137,029	12.26%	171
Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)	77,724	6.95%	98

52 Të dhëna sipas rezultateve përfundimtare të shpallura në www.sec.mk.

53 Rrethi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune u organizua në 29 komuna.

54 Më 21 prill 2013, u organizua rrethi i dytë i votimeve në Dollnen, ndërsa në Qendër, Gjorçe Petrov dhe Strugë u bë përsëritje e rrethit të dytë për shkak të anulimit të rezultateve, si pasojë e vendimit të Gjykatës Administrative.

Kandidatë të pavarur	45,612	4.08%	55
Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK)	28,565	2.56%	26
Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë (DPTM)	14,097	1.26%	22
Lidhja e Romëve të Maqedonisë (URM)	5,400	0.48%	11
Ripërtrirja Demokratike e Maqedonisë (DOM)	18,414	1.65%	9
Lëvizja Popullore për Maqedonisë (LPM)	9,008	0.81%	9
Partia Progresive Serbe (SPP)	10,992	0.98%	7
Lëvizja për Bashkim Kombëtar të Turqve në Maqedoni (LBKTM)	2,503	0.22%	5
Partia për Ardhmëri Europiane (PEI)	1,804	0.16%	5
Forcat e Bashkuara Demokratike të Romëve (UDFR)	2,121	0.19%	4
Lidhja Socialdemokratike (SDU)	8,638	0.77%	3
Partia Liberale (LP)	4,334	0.39%	2
SDPM – Partia Socialdemokrate e Maqedonisë	2,291	0.20%	1

Rezultatet zgjedhore për Këshillin e Qytetit të Shkupit		**%**	
Numri i përgjithshëm i votuesve	444,259		
Pjesëmarrja e votuesve	284,120	63.95%	
Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme	268,331	94.44%	
Numri i përgjithshëm i votave të pavlefshme	15,789	5.56%	
Partia	**Vota**	**%**	**Vende**
VMRO-DPMNE	121,881	45.42%	22
Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM)	80,112	29.86%	14
Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)	32,835	12.24%	5
Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)	16,459	6.13%	3
Ripërtrirja Demokratike e Maqedonisë (DOM)	6,056	2.26%	1
Aleanca e Forcave Majtiste të Titos (AFMT)	3,497	1.30%	0
Lidhja Socialdemokrate (SDU)	3,124	1.16%	0
Partia Liberale (LP)	2,426	0.90%	0
Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK)	1,941	0.72%	0

RRETH OSBE/ODIHR-IT

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon shtetet pjesëmarrëse "të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, shtetit të së drejtës dhe për të promovuar parimet e demokracisë dhe (…) për të ndërtuar, forcuar dhe mbrojtur institucionet demokratike, si dhe të promovojë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë" (Dokumenti i Helsinkit 1992). Ky përndryshe është i njohur si OSBE dimensioni njerëzor.

ODIHR me seli në Varshavë, Poloni, u krijua si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit në 1990 dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të gjerë, për përfshirjen e të drejtave të njeriut dhe demokratizimin. Sot, për të punojnë mbi 130 vetë.

ODIHR-i është agjencia kryesore në Europë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve çdo vit, për të vlerësuar nëse zgjedhjet në zonën e OSBE-së janë në përputhje me parimet e OSBE-së, legjislacionin vendas dhe standartet e tjera ndërkombëtare. Metodologjia unike siguron shqyrtim të gjithë elementëve të një procesi zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, ODIHRi ndihmon shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë fushat tematike të mëposhtme: qeverisjen e të drejtës, përkrahje ligjore, qeverisje demokratike, migrimin dhe lirinë e lëvizjes, si dhe barazinë gjinore. ODIHR-i zbaton një numër programesh të caktuara asistence çdo vit, duke synuar zhvillimin e strukturave demokratike.

OSBE/ODIHR gjithashtu i ndihmon shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrave të tyre për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore, konzistente me përkushtimet e dimensionit njerëzor të OSBE-së. Kjo arrihet duke punuar me shumë bashkëpunëtor për të nxitur bashkëpunim, për t'i përforcuar kapacitetet dhe të sigurohet ekspertizë në fusha tematike duke përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave njerëzore të personave të trafikuar, arsim dhe trajnim për të drejtat e njeriut, vëzhgim dhe raportim për të drejtat e njeriut, dhe të drejtat njerëzore dhe siguria e grave.

Në fushën e **tolerancës** dhe **mbrojtjen nga diskriminimi,** OSBE/ODIHR-ja u siguron përkrahje shteteve pjesëmarrëse për t'i përforëcuar veprimet e tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, anti-semitizmit dhe formave të tjera të mostolerancës. Aktivitetet e OSBE/ODIHR-së lidhur me tolerancën dhe mbrojtjen nga diskriminimi fokusohen në fushat e: legjislacionit, trajnim për zbatimin e ligjit; vëzhgim, raportim dhe ndjekje të përgjigjeve lidhur me krimet dhe incidentet e motivuara nga urrejtja; si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit të ndërmjetshëm.

OSBE/ODIHR-ja u jep këshilla shteteve pjesëmarrëse për politikat e tyre lidhur me **romët** dhe **sintit**. Promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin në mes komuniteteve rome dhe sinti, dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në organet e krijimit të politikave.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe veprimet në terren të OSBE-së, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Informata plotësuese mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it (www.osce.org/odihr).